

KOSOVA:
NJË STRATEGJI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK



TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	i
I. HYRJE.....	1
II. GJENDJA AKTUALE	2
A. POLITIKA DHE BIZNESI	3
B. EKONOMIA E LIGJSHME.....	5
C. EKONOMIA JOFORMALE	6
D. BUJQËSIA.....	9
E. SERBËT E KOSOVËS.....	10
F. PRANIA NDËRKOMBËTARE.....	11
III. STRATEGJIA NDËRKOMBËTARE	12
A. NDIHMA EMERGJENTE DHE RINDËRTIMI	13
1. Telekomunikacioni	14
2. Sektori i Energjitikës	15
3. Transporti dhe Integrimi Rajonal	16
B. KORNIZA LIGJORE	16
C. SEKTORI FINANCIAR.....	17
D. KOMERCIALIZIMI DHE PRIVATIZIMI	19
1. Rasti i Trepçes	21
IV. INVESTIMI NË NJERËZ	22
V. PËRFUNDIME	24

KOSOVA: NJË STRATEGJI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Kosova nuk mund të ketë të ardhme të qëndrueshme pa një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Ky raport shqyrton rrugët për arritjen e këtij zhvillimi. Pas analizimit të gjendjes aktuale të ekonomisë, raporti vlerëson përpjekjet e deritanishme ndërkombëtare për të hedhur themelet e mirëqënies së ardhshme. Ai gjithashtu shqyrton të ardhmen e sektorit ish-shoqëror, si dhe planet e privatizimit dhe mundësitë për ristrukturim dhe investime.

Rindërtimi në periudhën e pasluftës, pas fushatës së Ushtrisë Jugosllave dhe bombardimeve të NATO-s, është vetëm një nga sfidat e administratës ndërkombëtare. Pjesa dërrmuese e industrisë kosovare, e rrënuar nga keqadministrimi dhe e uritur për investime, edhe më parë ishte në gjendje të degraduar dhe gjithësesi nuk do të kishte pasur mundësi shpëtimi.

Me rënien e ekonomisë formale dhe me rritjen e shtypjes në vitet '90, tregu joformal ishte hapësira e vetme ekonomike – me përjashtim të bujqësisë – për shumicën e shqiptarëve. Kjo, së bashku me remitancat e të afërmeve që punonin në emigrim, ishin rrugët e vetme të mbijetesës. Falë „sistemit paralel“, aftësia sipërmarrëse e shqiptarëve ishte mjaft e zhvilluar para konfliktit të viteve 1998-99, dhe përparoi menjëherë pas rënies së mbizotërimit serb në qershor 1999.

Megjithatë, bumi i menjëhershëm në ndërtim dhe tregëti i filluar në vitin 1999 ka kufizime të dukshme. Ai nuk mund të plotësojë boshllëqet strukturore të ekonomisë. Një masë e madhe e popullsisë vazhdon të jetojë në varfëri. Mbështetja në remitancat e emigrantëve dhe

ndihmën e donatorëve nxjerr në pah mungesën e kapacitetit të brendshëm të ekonomisë kosovare.

Përparësitë ekonomike fillestare të UNMIK-ut ishin sigurimi i mallrave dhe shërbimeve elementare, ngritja e një rrjeti minimal të mirëqënies, dhe rindërtimi i shërbimeve. Realizimi i prioriteti të parë ka qenë përgjithësisht i suksesshëm, e po kështu ka pasur arritje të tjera të rëndësishme.

Regjistrimi i bizneseve ka qenë më i suksesshëm nga sa pritej. Është aplikuar një kornizë ligjore mjaft e mirë për aktivitet tregëtarë. Shërbimi i Doganave ka funksionuar në mënyrë të shkëlqyer si gjenerues i të ardhurave për Kosovën, falë bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar dhe vendor në trajnimin dhe zbatimin e rregullave doganore.

Në anën tjetër, përparimi në aspektin e shërbimeve ka qenë zhgënjyes. Për të fituar besueshmëri, bashkësia ndërkombëtare duhet të fillojë përmirësimin e energjisë, telekomunikacionit, ujit dhe rrugëve. Komunikimi me shtetet kufitare është i keq dhe duhet të përmirësohet nëse synohet rritja ekonomike dhe integrimi rajonal.

Administrata ndërkombëtare duhet të merret me problemet urgjente strukturore të sektorit industrial të Kosovës. Ka mundësi të mëdha për integrimin vertikal si në agro-industri ashtu dhe në prodhim, fusha në të cilat veprojnë rreth 100 ndërmarrje shoqërore premtuese. Për të zhvilluar kushtet e nevojshme konkurruese, Departamenti i Tregëtisë dhe Industrisë i UNMIK-ut, së bashku me juristët e OKB-së në Prishtinë dhe Nju Jork, duhet të ndërtojnë mekanizmat e nevojshme

përmes privatizimit, komercializimit kreativ, ndarjes së kompanive në degë më të vogla, apo përmes mënyrave të tjera për t'i bërë asetet sa më likuide.

Këto probleme ekonomike kanë gjithashtu një përmasë të drejtpërdrejtë politike, e cila ndikon të gjitha aspektet e zhvillimit strukturor dhe institucional në Kosovë. Investuesit e mundshëm janë penguar nga fakti se nuk kanë ditur se cilat ligje do të zbatohen përfundimisht. Ata kanë nevojë të besojnë se një ndryshim në të ardhmen i statusit politik nuk do t'i vinte në dyshim investimet e tyre apo nuk do ta tjetërsonte tërësisht mjedisin ku ata zhvillojnë biznesin e tyre. Kontradiktat në lidhje me pronësinë kanë një pasojë të ngjashme zbrapsëse.

Rrjedhimisht, UNMIK-u duhet të ngulmojë edhe më tej me privatizimin duke iu dhënë zgjidhje çështjeve mbi të drejtat e pronësisë që mund të dalin në këtë proces. Ai duhet t'i garantojë investuesit e mundshëm se çdo vendim mbi statusin përfundimtar do të përfshijë miratimin e sovranit të ardhshëm për vendimet mbi privatizimin dhe të drejtat që burojnë prej tyre, të përcaktuara gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar.

Ky hap është si urgjent ashtu dhe i drejtë duke pasur parasysh se UNMIK-u i ka kufizuar kompetencat e institucioneve vetëqeverisëse të Kosovës-të krijuara pas zgjedhjeve të nëntorit 2001-duke përjashtuar fushat më të rëndësishme të vendimmarrjes ekonomike.

Gjithashtu duhen gjetur mënyra për të ulur kriminalitetin. Forca e ligjit duhet të jetë më efektive dhe duhet të trajtohen çështjet e dështimit të sistemit të drejtësisë. Duhet të krijohet një mjedis në të cilin do të jetë më e lehtë dhe më me përfitim të veprohet në mënyrë të ligjshme se sa të jashtëligjshme. Duhet të zbatohen masa për të rritur besimin tek sistemi ligjor, siç janë skemat e mbrojtjes së dëshmitarit dhe viktimës, krahas fushatave të informimit publik mbi dëmet që i shkaktohen shoqërisë shmangia e paligjshme prej tatimeve.

Popullsia serbe e Kosovës është po aq e izoluar ekonomikisht sa edhe në aspekte të tjera. Megjithatë, pavarësisht nga frika dhe dyshimi i vazhdueshëm reciprok, rreth enklavave serbe zhvillohen kontakte të herëpashershme. Krijimi i

kontakteve tregëtare mes serbëve dhe shqiptarëve nuk është jetik vetëm për uljen e varfërsisë dhe izolimit ekonomik të serbëve të Kosovës. Ndonëse një mënyrë modeste, kjo është tepër e rëndësishme për rrëzimin e barrierave mes serbëve dhe shqiptarëve dhe mund të përbëjë një qasje të çmuar drejt zgjidhjes së problemit të sigurisë dhe krijimit të një mjedisi të sigurt për një shoqëri shumëetnike.

Ky raport arrin në përfundimin se ekziston rruga drejt përparimit ekonomik nëse krijohet një mjedis i lirë për privatizim, investime dhe ristrukturim; nëse korrupsioni dhe krimi vihen nën kontroll dhe nëse përmirësohet arsimit; nëse normalizohen marrëdhëniet e Kosovës me fqinjët dhe nëse ekonomia e saj integrohet me rajonin; nëse UNMIK-u gjen mundësi për të ecur përpara me privatizimin; dhe nëse zgjidhet çështja më e rëndësishme politike, ajo e statusit përfundimtar.

REKOMANDIME

Për Vendet Donatore Dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare

1. Vazhdoni të ofroni ndihmë të qëndrueshme, sepse Kosova nuk ka mundësi për mjete të mjaftueshme pa u zgjidhur statusi i saj përfundimtar.
2. Punoni me Shqipërinë për të ndërtuar një rrugë të re nga Kosova në Durrës si hap i rëndësishëm për integrimin më të mirë të Kosovës me ekonominë rajonale dhe më gjerë me të europiane.
3. Ushtroni presion mbi vendet e rajonit që të njohin regjistrimin e automjeteve të Kosovës si dhe të dokumenteve të udhëtimit, si një hap i mëtejshëm për integrimin më të mirë të Kosovës në ekonominë rajonale dhe më gjerë në atë europiane.
4. Vazhdoni të siguronit investime, ekspertizë dhe trajnime për Institutin e Statistikës të Kosovës.

PËR UNMIK-un

5. Ecnit më tej me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, çka është thelbësore për

- rimëkëmbjen ekonomike, duke marë parasysh propozimet e Departamentit të Tregëtisë dhe Industrisë, dhe zgjeroni metodat kreative të Departamentit të Tregëtisë dhe Industrisë për komercializimin e ndërmarrjeve shoqërore.
6. Përdorni autoritetin e bashkësisë ndërkombëtare për të tërhequr investues të mundshëm, duke u garantuar atyre se zgjidhja e statusit përfundimtar do të përfshijë miratimin e sovranit të ardhshëm për vendimet e privatizimit dhe të drejtat e fituara prej tij gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar.
 7. Risni aftësinë e sistemit gjyqësor për të trajtuar konfliktet komerciale, si një masë e mëtejshme urgjente për të përmirësuar mjedisin e investimeve.
 8. Kini përparësi kryesore, në bashkëpunim me udhëheqësit kosovarë, një sistem arsimimi që do të mund të përgatisë të rinjtë në përputhje me kërkesat e ekonomisë bashkëkohore.
 9. Merrni masat, përfshi një fushatë informimi, për të rritur besimin e njerëzve tek sistemi gjyqësor, në mënyrë që të nxitet kallëzimi i krimeve, përfshi korrupsionin, grabitjen dhe mashtrimin në nivel të lartë, të cilat po e dobësojnë ekonominë.
 10. Ndaloni, ose të paktën zvogëloni, mospërputhjen mes rrogave të kosovarëve të paguar nga organizatat ndërkombëtare (si UN dhe OSBE) dhe atyre të paguar nga administrata vendore, gjyqësore apo struktura të tjera të themeluara nga UNMIK-u.
 11. Jepuni rëndësi më të madhe trajnimeve praktike për zyrtarët vendorë të administratës, duke e ruajtur numrin e zyrtarëve ndërkombëtarë në administratën civile deri sa zyrtarët vendorë të jenë të gatshëm për të marë kontrollin e këtyre funksioneve.
 12. Vizioni me modernizimin e shërbimit doganor duke përfshirë rritjen e numrit të kompjuterave për të siguruar të dhëna të sakta dhe të besueshme.
 13. Merrni masa të rrepta ndaj shkeljeve të marrëveshjes tregëtare mes Kosovës dhe Maqedonisë.
 14. Synoni ristrukturimin e bujqësisë, sepse shumë bujq të vegjël zotërojnë ferma të vogla, prodhimi i të cilave nuk mund të konkurrojë me importet.

Prishtinë/Bruksel, 19 dhjetor, 2001

KOSOVA: NJË STRATEGJI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK

I. HYRJE

Kosova nuk mund të ketë të ardhme të qëndrueshme pa një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Krijimi i kushteve për një zhvillim të tillë, mbi të gjitha ve në provë Shtyllën e Katërt të UNMIK-ut të drejtuar nga Bashkimi Europian¹.

UNMIK-ut i takon të themelojë një ekonomi tregu funksionale të bazuar në ligj dhe tërheqëse për investuesit. Rindërtimi i periudhës së pasluftës, pas fushatës së Ushtrisë Jugosllave dhe bombardimeve të NATO-s, është vetëm një hap në këtë drejtim. Pjesa dërrmuese e industrisë kosovare, e rrënuar nga keqadministrimi dhe e uritur për investime, ishte në gjendje të degraduar dhe gjithësesi nuk do të kishte pasur mundësi shpëtimi.

Projektet afatgjata të zhvillimit janë veçanërisht të kërcënuara nga tradita dhjetëvjeçare e ndarjes mes ekonomisë formale e të dobësuar, të mbizotëruar nga serbët, dhe aktivitetit ekonomik joformal në kuadër të „sistemit paralel“ që shqiptarët krijuan në vitet '90. Me rënien e ekonomisë zyrtare tregu joformal ishte hapësira e vetme ekonomike – me përjashtim të bujqësisë - për shumicën e shqiptarëve. Kjo, së bashku me remitancat e të afërmeve që punonin në emigrim, ishin rrugët e vetme të mbijetesës. Ky ishte një mjedis që thajse nuk ofronte asnjë mundësi për zhvillim ekonomik.

Me mbërritjen e KFOR-it në 12 qershor 1999, doli në pah talenti sipërmarrës i vendasve. Shkalla e lartë e aktiviteteve ekonomike që u arrit brenda pak ditëve, dhe llojshmëria e shumë të produkteve ushqimore që mund të gjendeshin në

shitore, i befaskan ndërkombëtarët që vinin në Kosovë, sidomos ata që kishin menduar se do të gjenin një rrënim të ngjashëm me atë të Bosnjës pas Dejtonit.

Ende vihet re kontrasti mes mbeturinave thajse në zhdukje të ekonomisë socialiste jugosllave dhe ekonomisë tepër të gjallë joformale, e cila e nxitur nga remitancat e emigrantëve është në lulëzim prej përfundimit të sundimit të Beogradit. Ky lulëzim është pasojë e pandërgjegjësme e politikave të detyruara nga serbët, të cilët morën nën kontroll të gjitha bizneset shtetërore dhe shoqërore si dhe sistemin e arsimit në vitin 1990/1, duke flakur në rrugë të gjithë drejtuesit shqiptarë, me përjashtim të disa shqiptarëve, dhe këta punëtorë krahu.

Po kështu, sistemi u ndryshua për t'i penguar shqiptarët në transaksionet e ligjshme komerciale dhe pronësore, sidomos për t'u blerë serbëve pasuri të palujtshme, ndonëse transaksione të tilla ka pasur, por ose nuk janë regjistruar ose vetëm zyrtarisht janë bërë në emër të serbëve. Këto kufizime i detyruan njerëzit të gjenin mënyra të tjera për sigurimin e të ardhurave, duke nxitur lulëzimin e një ekonomie tregu paralele me atë formale të drejtuar nga serbët.

Natyrisht, zhvillimi i vërtetë ekonomik është i pamundur pa sigurinë fizike dhe sundimin e ligjit, asnjëra prej të cilave nuk është ende e plotë në Kosovë. Po aq i rëndësishëm është krijimi i një sektori të shëndetshëm financiar i aftë të ofrojë shërbime, sidomos dhënie kredish, sa edhe zhvillimi i nevojave të biznesit.

Këto probleme ekonomike kanë gjithashtu një përmasë të drejtpërdrejtë politike e cila ndikon të gjitha aspektet e zhvillimit strukturor dhe

institucional në Kosovë. Investuesit e mundshëm janë penguar nga fakti se nuk kanë ditur se cilat ligje do të zbatohen përfundimisht. Ata kanë nevojë të besojnë se një ndryshim i ardhshëm i statusit politik, nuk do t'i vinte në dyshim investimet e tyre apo nuk do ta tjetërsonte tërësisht mjedisin ku ata zhvillojnë biznesin e tyre. Kontradiktat në lidhje me pronësinë kanë pasur një pasojë të ngjashme zbrapsëse.

Zhvillimi ekonomik është tepër i rëndësishëm dhe tepër urgjent për të pritur zgjidhjen e statusit afatgjatë të Kosovës. Për këtë arsye, UNMIK-u duhet të vijojë me privatizimin, duke zgjidhur problemet e pronësisë që mund të lindin në këtë proces. Për të gjetur investues e për t'u ofruar atyre besimin e nevojshëm, UNMIK-u duhet t'u garantojë atyre se çdo vendim mbi statusin përfundimtar do të përfshijë miratimin e sovranit të ardhshëm për vendimet mbi privatizimin dhe të drejtat që burojnë prej tyre të përcaktuara gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar.

II. GJENDJA AKTUALE

Megjithë gjallërimin e pjesshëm pas mbërritjes së UNMIK-ut, aktiviteti ekonomik në Kosovë mbetet i kufizuar. Sipas Bankës Botërore, në nëntor 2000, prodhimi i përgjithshëm vendas (GDP) i provincës ishte 3 miliardë DEM (1.4 miliardë US\$), apo rreth 1,400 DEM per capita (për frymë/banor)². Kjo përbën një rritje mjaft të lartë, krahasuar me 840 DEM per capita³, në nëntor 1999. Kjo rritje e menjëhershme është në vijim të rënies prej 50% në vitet e kontrollit serb pas 1989-ës. Sipas statistikave zyrtare, në 1995 GDP-ja per capita kishte rënë në 840 DEM.

Megjithatë, një pjesë e madhe e popullsisë vazhdon të jetojë në kushte jashtëzakonisht të vështira. Një raport i Bankës Botërore për shkallën e varfërisë, bazuar tek të dhënat e Anketës mbi Standartin e Jetesës, zhvilluar në dhjetor 2000 me 2,800 familje, shpall se mbi 12% e popullatës së Kosovës jeton në varfëri të skajshme⁴.

Remitancat e emigrantëve kanë rëndësi vendimtare. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, ato arrijnë në 1.2 miliardë DEM në vit – pra më tepër se 40% e GDP-së. Meqenëse eksportet e Kosovës janë të papërfillshme dhe importet arrijnë në 85% të GDP-së, këto remitancat së bashku me ndihmat humanitare prej 310 milion DEM (10% e GDP-së), janë faktor vendimtar në plotësimin e deficitit tregëtar⁵.

Një nga përparësitë e Shtyllës IV prej dhjetorit 1999, ka qenë krijimi i kornizës institucionale si parakusht për rimëkëmbjen ekonomike. Kërkesa e parë për zhvillimin e politikave të shëndosha ekonomike, është krijimi i një agjensie të saktë për mbledhjen e të dhënave. Aktualisht, të dhënat e vetme që u jepen UNMIK-ut, BE-së, dhe donatorëve ndërkombëtarë, vijnë nga Instituti i Statistikës i Kosovës. Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Vlerësimin Statistikor, e themeloi këtë zyrë në korrik 2000, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si edhe për zbatimin e procesit të regjistrimit të bizneseve. Ndonëse Instituti i Statistikës ka përparuar, ende nevojitet ndihma ndërkombëtare për trajnime dhe çuarje të metodologjisë në standartet ndërkombëtare.

Njësia monetare zyrtare e Kosovës është Marka gjermane. Ajo u njoh si e tillë në shtator 1999,

dhe do të zëvendësohet nga EURO në fillim të 2002. Përpjekjet për ta përgatitur popullin për EURO-n kanë qenë përgjithësisht më të pakta se në vendet europiane të EURO zonës. P.sh. është bërë shumë pak për të filluar sistemin e çmimeve të dyfishta, ndonëse kjo është praktikuar për një vit në Europë. Megjithatë, pakkush dyshon në suksesin e këtij procesi. Njerëzit kanë mjaft përvojë me ndryshimin e njësisë monetare në ish-Jugosllavi, për shkak të ndryshimeve të shpeshta të Dinarit. Përshtatja me normat e luhatëshme të këmbimit ka qenë pjesë e përditshmërisë për shumë kohë.

Duke qenë një provincë pa dalje në det dhe e varur në tregëti nga fqinjët, Kosova duhet të zhvillojë ata sektorë ku mund të jetë konkurrenë. Forca punëtore është e shumtë dhe e lirë. Ekzistojnë mundësi të mëdha për integrim vertikal në agro-industri dhe prodhim. Në këta dy sektorë veprojnë rreth 100 ndërmarrje shoqërore që kanë mundësi për sukses⁶. Për të zhvilluar kushtet e nevojshme konkurruese, Departamenti i Tregëtisë dhe Industrisë i UNMIK-ut, së bashku me juristët e OKB-së në Prishtinë dhe Nju Jork, duhet të ndërtojnë mekanizmat e nevojshme përmes privatizimit, komercializimit kreativ, ndarjes së kompanive në degë më të vogla, apo përmes mënyrave të tjera, për t'i bërë asetet sa më likuide, në mënyrë që të shfrytëzohen potencialet e këtyre sektorëve.

Përparësitë ekonomike fillestare të UNMIK-ut ishin sigurimi i mallrave dhe shërbimeve elementare, ngritja e një rrjeti minimal të mirëqenies, dhe rindërtimi i shërbimeve. Realizimi i përparësisë së parë ka qenë përgjithësisht i suksesshëm, por sektori i shërbimeve ka qenë zhgënjës. Për ta ruajtur besueshmërinë, bashkësia ndërkombëtare duhet të fillojë strukturimin e shërbimeve, sidomos të rrymës, telekomunikacionit, ujit dhe rrugëve. Në mungesë të rezultateve konkrete do të rritet presioni i popullit për ndryshimin e menaxhimit të rindërtimit brenda kuadrin të UNMIK-ut. Në një rast jo të largët, pas dy muajsh të ndërprerjeve të shpeshta dhe rrënuese të rrymës, një gazetë e rëndësishme vendore bëri thirrje për largimin (origjinal: kthimin në shtëpi) e kryesuesit të Bordit Mbikqyrës të Korporatës Energjitike të Kosovës (KEK)⁷.

Një hap vendimtar në strategjinë e UNMIK-ut për transferimin e përgjegjësisë qeverisëse tek

institucionet vendore, ishin zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit 2001⁸. Korniza kushtetuese mundëson dhënien e mjaft kompetencave në fusha të caktuara për institucionet vetëqeverisëse të dala nga këto zgjedhje. Këto kompetenca përfshijnë aspekte të politikës ekonomike dhe financiare, çështje buxhetore dhe fiskale dhe disa fusha të rëndësishme buxhetore si shëndetësia, puna dhe mirëqenia shoqërore, transporti dhe telekomunikacioni, si edhe bujqësia⁹.

Megjithatë, këto institucione të reja do të kenë ndikim të vogël mbi politikën madhore ekonomike sepse kompetencat e tyre në këtë drejtim janë tepër të kufizuara, dhe Korniza Kushtetuese i mundëson pushtet të lartë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP). Ky pushtet përfshin miratimin përfundimtar të buxhetit të konsoliduar; politikën monetare; caktimin e revizionimit të jashtëm të pavarur të buxhetit; kontrollin e shërbimit doganor; kontrollin e transportit ndërkufitar/kufitar të mallrave; autoritetin për të administruar pronat publike, shtetërore dhe shoqërore; caktimin e rregullave për ndërmarrjet publike dhe shoqërore; kontrollin mbi hekurudhat dhe aviacionin civil; kontrollin mbi Drejtorinë e Strehimit dhe Pronave; përcaktimin e ligjshmërisë dhe kompetencave për zgjidhjen e konflikteve komerciale dhe pronësore; si dhe emërimin e kryesuesve të institucioneve të rëndësishme si Autoriteti Bankar dhe i Pagesave dhe Inspektorati i Tatimeve¹⁰. Rrjedhimisht, institucionet e reja të Kosovës nuk do të kenë mundësi të trajtojnë sfidat kryesore të zhvillimit ekonomik. Në një situatë të tillë, i takon UNMIK-ut të veprojë sipas propozimeve të këtij raporti.

A. POLITIKA DHE BIZNESI

Ashtu si edhe gjatë periudhës së Milosheviçit, shqiptarët e Kosovës janë tepër të zënë me çdo lloj aktiviteti që u siguron të ardhura për të mbajtur familjet e tyre. Megjithatë, ndryshimi mes fillimit të viteve '90 dhe të sotmes mund të vihet re në të gjithë provincën. Jo vetëm rindërtimi, por edhe investimet e brendëshme kanë lulëzuar. Bizneset janë shtuar si kërpudhat. Ato pjesë të qyteteve që dikur kanë qenë vetëm rrethina të shpërfillura, sot po rindërtohen. Një serb i Prishtinës që kthehej për të parë banesën e

tij u shpreh kështu për ICG-në: 'Qyteti po lulëzon. Ata kanë bërë tepër shumë në një vit.'

Shumë familje kanë burime të shumfishta të të ardhurave: remitanca nga diaspora; ushqim i kultivuar vetë në copa të vogla toka; ndërmarrje familjare si restorante apo shitore të vogla, të gjitha në të mirë të të ardhurave të familjes. Duke qenë se shumica e punëdhënësve madhore janë në pritje të vendimeve të UNMIK-ut për komercializimin/privatizimin, shumica e njerëzve kanë qenë të detyruar të krijojnë mundësitë e veta për të siguruar të ardhura.

Ndërhyrja e partive kryesore shqiptare të Kosovës në kompanitë ish-shtetërore madje dhe në institucionet publike, është karakteristike për këtë vend, dhe kjo si pasojë e politikanëve të edukuar në një mjedis njëpartiak, të cilët e përdorin këtë si metodën e vetme për të siguruar pushtet dhe përfitime ekonomike. Në mungesë të strukturave ligjore efektive, dhe me lidhjet ndërkufitare dhe sistemet tregëtare paralele të zhvilluara në vite, elementët kriminalë janë më të organizuar se në ekonomitë e tjera në tranzicion, dhe kanë pozicion më të përshtatshëm se ndërmarrjet e ligjshme për të shfrytëzuar mundësitë që krijohen. Ekonomitë e ligjshme dhe të jashtëligjshme ndahen nga një zonë (Tokë e askujt) e gjerë dhe lehtësisht e kalueshme, që është ekonomia joformale.

Në vitin 1992, viti i tretë i sundimit të drejtprdrejtë të Beogradit, Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila bashkërendonte rezistencën paqësore shqiptare, organizoi zgjedhje paralele, të cilat sollën themelimin e Republikës së vetëshpallur të Kosovës nën presidencën e Ibrahim Rugovës. Ky hap ishte gurthemeli i krijimit të një shoqërie paralele. Duke përdorur një fond të krijuar nga tatimi vullnetar 3% mbi të ardhurat personale në Kosovë dhe në diasporë, parlamenti hije i drejtuar nga LDK-ja dhe kryeministri Bujar Bukoshi, ishte në gjendje të financonte një numër programesh shoqërore, sidomos shkollat dhe shërbimin shëndetësor.

Pas Marrëveshjes së Dejtonit në 1995 që i dha fund luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë por e anashkaloi problemin e Kosovës, u krijua një çarje mes atyre që përkrahnin rezistencën paqësore, të përfaqësuar nga LDK-ja, dhe të tjerëve që përkrahnin përdorimin e dhunës, të

përfaqësuar nga një numër grupesh nën emërtimin Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK).

Shqiptarët vazhdonin ta paguanin tatimin vullnetar 3%. Por edhe krahu i „marketingut“ të UÇK-së së sapolindur kishte vënë në shënjestër biznese të mëdha dhe njerëz të biznesit. Një shqiptar i intervistuar nga ICG-ja pranon se dhurata e tij për këtë grupim mund të quhej „grabitje e justifikuar“.

Prirë nga trupat e NATO-s në 1999, UÇK-ja fitimtare sendërtoi planet e hartuara gjatë bombardimeve të NATO-s për të marrë kontrollin e pushtetit. Duke nxjerrë si justifikim marrëveshjen e Rambujesë¹¹, UÇK-ja themeloi një „Qeveri të Përkohëshme të Kosovës“ të kryesuar nga shefi politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, anëtarët e së cilës sot përbëjnë trupën drejtuese të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Qeveria e Përkohëshme nuk u mjaftua me emërimin e këshillave komunale dhe të ministrive qendrore; përkrahësit e saj morën në kontroll aq biznese sa mundën.

Me krijimin e UNMIK-ut u përcaktuan modele të tjera politike dhe ekonomike. Përjekjet ndërkombëtare për krijimin e kornizës ligjore dhe institucionale në ndihmë të një ekonomie tregu funksionale dhe nxitjes së ristrukturimit e zhvillimit të ndërmarrjeve të shëndetëshme, u përballën „me realitetin e mjedisit“.

Ndërkohë që Qeveria e Përkohëshme e Thaçit kinse rezervoi disa vende për LDK-në, kjo e fundit refuzoi bashkëpunimin duke krijuar struktura paralele bazuar në postet e viteve '80. Kjo solli një situatë në të cilën disa biznese drejtoreshin nga dy menaxherë, përkatësisht të orientuar nga LDK-ja dhe UÇK-ja, të dy dikur të flakur nga serbët dhe të dy me dëshirën e rimarrjes së posteve të dikurshme. Natyrisht që ka pasur llojshmëri kombinimesh brenda kësaj prirjeje të përgjithshme.

Situata u turbullua edhe më tepër nga pësjtjellimi rreth pronësisë së ndërmarrjeve të krijuara në bazë të doktrinës titiste të „pronësisë shoqërore“. Derisa UNMIK-u gjeti njerëzit e përshtatshëm për t'u përballur me këto çështje, veteranët ishin organizuar më së miri¹². Në shumë aspekte, Kosova është ende e ndarë mes rajoneve të kontrolluara nga ish-komandantët që morën

pushtet gjatë konfliktit dhe atyre që mbetën në strukturat e mëparshme të pushtetit.

Një nga bizneset e fuqishme të krijuara ishte dhe kompania me fitim të madh Kosova Petrol, e krijuar nga shkrija e aseteve provinciale të Beopetrol-it dhe JugoPetrol-it. Marrja e tyre në kontroll u justifikua me faktin se këto ndërmarrje u përkisnin ish-punëtorëve shqiptarë, dhe menaxherët po i rivinin ato në punë. Në rastin e Grand Hotel në Prishtinë, menaxhimi aktual u përball me një ndërtesë të boshatisur dhe të plaçkitur dhe ka investuar një fitim prej 12 milion DEM për rindërtimin e kësaj ndërtese dhe pronave të tjera të të njëjtit grup¹³. Fabrika e birrës në Pejë ka ndeshur në sfida të ngjashme në përpjekje për të rikrijuar tregun e saj, ku edhe është penguar nga luhatjet e furnizimit me rrymë. Kompanitë e ndërtimit kanë përparuar, por bizneset e tjera e kanë pasur shumë të vështirë, përfshi këtu edhe industrinë metalpunuese dhe bizneset që përpunojnë lëndë të para të importuara. Cilësia e menaxherëve është mjaft e ndryshme, nga profesionistë cilësorë deri tek oportunistë thjesht politikë.

Duke mos pasur përvojë në drejtimin e çështjeve komerciale në përputhje me standartet përendimore të rregullave të kontabilitetit (e në disa raste duke mos pasur dëshirë për transparencë), këta menaxherë shpeshherë të vetëmëruar në të vërtetë i kanë privatizuar këto kompani. Përgjigjja e bashkësisë ndërkombëtare ndaj kësaj ka qenë shpeshherë e tipit „bëj sikur nuk di gjë“. Për më tepër, ato biznese që u privatizuan në këtë mënyrë, „de facto“ njihen nga Autoriteti Qendror Fiskal (AQF) si të ligjshme për t'u tatuar.

B. EKONOMIA E LIGJSHME

Përparësi e UNMIK-ut ka qenë kalimi i aktiviteteve të biznesit në sektorin e ligjshëm. Regjistrimi i bizneseve filloi në fillim të 2000, bazuar në regjistrimin në nivelin komunal. Detyrimet e ndërmarrjeve të vogla mbeteshin në atë nivel administrativ, ndërsa detyrimet e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha i kalonin administratës qendrore në Prishtinë¹⁵. Siç e tregon edhe tabela e mëposhtme, regjistrimi i bizneseve ka qenë mjaft i suksesshëm. Këto të dhëna gjithashtu tregojnë edhe epërsinë e biznesit të vogël. Kështu, nga 14,669 biznese të

regjistruar në dhjetor 2000, 13,256 kanë pasur një pronar të vetëm, ndërsa 550 kanë qenë partneritete nga të cilat 80 të regjistruara si shoqëri me kapital të përbashkët dhe 300 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Këto shifra janë përballë 387 kompanive shtetërore dhe shoqërore. Përveç kësaj, në dhjetor 2000 ka pasur edhe 14,912 të ashtuquajtur të vetëpunësuar, kryesisht në tregëtinë me shumicë dhe pakicë, të cilët kanë punësuar nga një ose dy persona.

Biznese të regjistruara ¹⁶		
Numri i punëtorëve	31 dhjetor 2000	18 shtator 2001
Më pak se 4	11,357	35,970
5-9	2,627	3,694
10-49	433	522
50-99	92	111
Më shumë se 100	160	201
Totali	14,669	40,498

Këto biznese të regjistruara rishtaz janë biznese ekzistuese dhe të sapokrijuara. Aftësia e AQF-së për zbatimin e regjistrimit dhe vullneti i bizneseve për t'u regjistruar përbën një arritje të rëndësishme, që i kalon bizneset në sektorin e ligjshëm dhe e zgjeron bazën e tatimeve. Përcaktimi i bizneseve si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëri me kapital të përbashkët duhet parë me dyshim, sepse në kohën e regjistrimit të tyre në vitin 2000, nuk ishte hartuar ende Rregullorja mbi shoqëritë me kapital të përbashkët. Është e mundëshme të kenë mbijetuar ende disa shoqëri më përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të para 1990-ës, por numri i tyre i vërtetë është i paqartë.

Më tepër se gjysma e bizneseve të regjistruar janë në fushën e shitjeve me shumicë e pakicë, riparimin e automjeteve, motoçikletave dhe aparateve vetjake dhe shtëpiake, me 11% të tyre në prodhim dhe 11% të tjera në transport, magazinim dhe komunikacion. Çuditërisht, megjithë numrin e madh të bareve dhe restoranteve, ky sektor zë vetëm 4% të

ndërmarrjeve të regjistruara, ndonëse në këtë aktivitet përfshihen 13% e të vetëpunësuarve. Rreth 7% e bizneseve veprojnë në ndërtimtari.

Megjithëse tregëtia me shumicë dhe pakicë është e rëndësishme, ajo mund të mbijetojë vetëm në sajë të një ekonomie me baza të forta e cila ofron rroga për ata që do të jenë klientë të shitoreve dhe importuesve të mallit. Disa aktivitete industriale që mund të kenë të ardhme mund të jenë agro-industria dhe industria e përpunimit ushqimor, si edhe prodhimi i mallrave me TVSh të lartë, si tekstilet dhe pajisjet e ndryshme, që ofrojnë më tepër mundësi për të zëvendësuar importet. Por kjo arrihet nëse prodhimi ndërtohet mbi profesionalizëm dhe aftësi të larta, çka nënkupton se e ardhmja e ekonomisë në Kosovë varet nga krijimi i një force punëtore tepër të arsimuar. Kjo gjithashtu nënkupton që produktet kosovare duhet të jenë konkurruese me produktet e tjera të prodhuara dhe të shitura në të njëjtën kohë në mbarë rajonin.

Ndërkohë, biznesmenët kosovarë vazhdojnë zhvillimin brenda mundësive të tyre. Bashkimi i Biznesit Shqiptar, i themeluar në nëntor 2000, synon të bashkojë kryesuesit e bizneseve në diasporë si edhe në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, për të pasur përkrahje, investime dhe tregëti të përbashkët¹⁷.

Lulëzimi fillestar i ndërtimeve u bazua në kursimet vetjake, të ardhurat nga jashtë dhe burime të tjera familjare. Kjo nuk përbën një bazë të mjaftueshme për zhvillim afatgjatë. Ka një nevojë urgjente për agjensi ndërkombëtare financimesh që do të siguronin mjete shtesë kreditimesh, për të mundësuar zgjerimin e mëtejshëm të bizneseve të suksesshme.

Një faktor tjetër që ka penguar tregëtinë me jashtë dhe që lidhet me çështjen e statusit afatgjatë të Kosovës, ka qenë përcaktimi i vendit të prodhimit në etiketat e produkteve. P.sh., kantina shtetërore e verës në Suharekë dhe Rahovec kishte rreth 30 deri 40 milion litra verë në kade gati për shitje, një pjesë e së cilës ishte derdhur gjatë bombardimeve të NATO-s dhe një pjesë „kishte avulluar“. Gjatë regjimit të mëparshëm, shumica e këtij produkti shkonte në Slloveni ose Beograd ku hidhej në shishe me emra të ndryshëm, por gjithashtu një pjesë merrej nga një klient gjerman, Raেকে, ku hidhej në shishe me emrin Amsfelder. Duke u përpjekur të

rilidhet me këtë klient, menaxhimi i kantinës u ndesh me rregullat e Bashkimit Europian mbi vendin e prodhimit. Kjo nënkuptonte që shisheet duhet të kishin etiketën e FRY-së (RFJ-së), çka ishte e papranueshme për menaxhuesit shqiptarë të kantinës. Më në fund u arrit një kompromis, i cili nënkuptonte përdorimin e etiketës „Kosova – BRJ“¹⁸, por për këtë u deshën shumë muaj grindjesh. Diçka e ngjashme ndodhi me fabrikën e ëmbëlsirave Jatex, në Gjakovë, e cila refuzoi porosi nga kompani zvicerane, gjermane dhe austriake me vlerë 5 milion DEM¹⁹.

C. EKONOMIA JOFORMALE

Gjatë viteve 1990, kur shqiptarët u përjashtuan thuajse tërësisht nga aktivitetet e ligjshme ekonomike, fuqizimi i sektorit joformal ishte një pasojë anësore e pashmangëshme e politikës së Beogradit. Ajo praktikë e të punuarit e krijuar atëherë vazhdon edhe sot. Sfida e UNMIK-ut është si ta integrojë sa më mirë ekonominë joformale në ekonominë e ligjshme. Siç është sipërpërmendur, një sukses i rëndësishëm është arritur në regjistrimin ligjor të bizneseve. Strategjia më efektive do të ishte mundësimi i kostos së ulët të kalimit në sistemin e ligjshëm, kjo kombinuar me revizionim të fortë për të nxitur pajtimin me ligjin. Në përgjithësi, mundësia e lartë për t'u kapur dhe ndëshkuar është më efektive se moria e sistemeve burokratike, të cilat nxisin pështjellimet dhe fshehin përgjegjësinë e vërtetë.

Kostoja e regjistrimit të bizneseve është minimale. Megjithatë, kjo ka disa përparësi dhe një mangësi të qartë: regjistrimi e ekspozon një biznes ndaj mekanizmit revizionues të AQF-së. Në 29 tetor 2001, Rregullorja 30 e UNMIK-ut krijoi Bordin e Standarteve të Kosovës për raportet financiare dhe Regjimin e Raportimit Financiar për Organizatat e Biznesit. Duke komentuar suksesin e procesit të regjistrimit, një zyrtar i UNMIK-ut pohonte se „Fakti që shumë biznese po regjistrohen i nderon qytetarët e Kosovës. UNMIK-u ka bërë shumë pak për të nxitur dhe reklamuar pjesëmarrjen²⁰. Një masë që UNMIK-u mund të marrë në përpjekje për t'i bindur bizneset të regjistrohen, është dhënia e linjave telefonike fikse përmes PTK-së. Nëse një biznes ka lidhje telefonike, atëherë është e mundshme t'i kërkohet regjistrimi. Megjithatë mungesa e mbikqyrjes së rreptë nga PTK-ja (e

cila vuan nga miqësitë si edhe institucionet e tjera) e zbeh vlerën e kësaj metode në zbulimin e bizneseve të paregjistruara.

Sistemi i tatimit nuk është mbingarkues. Struktura e tatimit për bizneset e mëdha dhe të vogla është e arsyeshme dhe intervistat me pronarë të ndryshëm biznesesh kanë vënë në dukje shumë pak ankesa²¹. Zbatimi i sistemit të tatimit është përforcuar nga rregullorja e UNMIK-ut që përcakton standartet e kontabilitetit. Siç ka theksuar edhe një zyrtar i AQF-së „Kjo jo vetëm përcakton standartet e kontabilitetit sipas standarteve ndërkombëtare, por ndihmon edhe në njësimin e procesit revizionues“²². Para kësaj rregulloreje, AQF-së i duhej të përcaktonte procedurat e revizionimit pa një kornizë rregulluese. Këto përpjekje kanë qenë të suksesshme në frenimin e shprehive të vjetra të krijuara gjatë sistemit paralel.

Lulëzimi i industrisë së ndërtimit prej qershorit 1999, ka pasur edhe rezultate të pakëndëshme. Ndërtimet e paligjshme përbëjnë një nga shqetësimet kryesore për autoritetet komunale në të gjithë Kosovën, të cilët kanë qasje të ndryshme ndaj tyre, në varësi të presioneve me të cilat ndeshen. Rezultati më famëkeq i përpjekjeve për të kontrolluar një aktivitet të tillë, ishte vrasja në 11 shtator 2000, në Prishtinë, e Drejtorit të Departamentit komunal të Planifikimit, Rindërtimit dhe Zhvillimit, arkitektit të respektuar Rexhep Luci. Dyshohej se vrasja u organizua nga disa elementë që qëndronin pas disa ndërtimeve të paligjshme që Luci synonte t'i shembte. Artikuj në shtyp raportojnë se rreth 3,200 ndërtime të ngritura në periudhën qershor 1999 – janar 2001 në Prishtinë, do të legalizoheshin²³. Kjo shifër krijon një ide mbi shkallën e këtij aktiviteti. Autoritetet komunale tani i qasen në mënyrë më realiste këtij problemi; ndërtimet do të lejohen me përjashtim të rasteve kur bien ndesh me rregullat e shërbimeve komunale apo kur janë të pasigurta²⁴. Rreth 90% e ndërtimeve të reja mund të legalizohen në këtë mënyrë. Për pjesën që mbetet, do të shihet nëse do ketë vullnet të mjaftueshëm politik mes zyrtarëve vendorë apo ndërkombëtarë për t'i shembur ato, sidomos në rastet kur përfshihen interesa të fuqishme lokale.

Tatimet dhe detyrimet zyrtare janë njëra anë, por tregëtarëve u kërkohen edhe donacione për struktura jozyrtare, të cilat supozohet të jenë të

lidhura me ish-anëtarët e UÇK-së dhe/ose elementë kriminalë, dhe është në interesin e tregëtarëve të mos i shpërfillin këto struktura. Në mesin e vitit 2000, në përvjetorin e mbarimit të bombardimeve të NATO-s, pati një vërshim të ndërtimit të monumenteve për heronjtë e rënë të UÇK-së, financuar nga donacionet vullnetare me vlerë rreth 100,000 DEM.

Ka prova të shumta gojore se pasardhësit e UÇK-së, Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), i plotësojnë fondet e pakta të siguruara nga organizatat ndërkombëtare, me donacione vendore të drejtpërdrejta apo përmes organizatës “Miq të TMK-së”. Kontakte jozyrtare thonë se organizatat e lidhura me ish-UÇK-në mbledhin shuma mujore prej 300 DEM deri 3,000 DEM nga një biznes, donacion që llogaritet më tepër nga fusha e veprimtarisë së biznesit sesa nga qarkullimi i tij. “Fondi Vendlindja Thërret” që ishte ngritur në diasporë për të mbështetur UÇK-në gjatë konfliktit, duket se funksionon ende. Një pyetje e rëndësishme por pa përgjigje është ajo mbi fatin e këtyre parave dhe të parave të tjera të mbledhura nga strukturat paralele, që përfaqëson një nga rrugët e shterimit të ekonomisë. Asnjë prej këtyre shumave nuk i kalon sferës publike për përmirësimin e infrastrukturës – rrugëve, furnizimit me ujë, grumbullimit të mbeturinave etj.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është hyrja e fondeve nga diaspora, kryesisht nga Zvicra dhe Gjermania. Një studim i institutit ekonomik të Kosovës, Riinvest, në 1999, tregonte se totali i fondeve të ardhura nga diaspora ishte 800 milion DEM në vit, apo rreth 5,500 DEM për familje²⁵. Banka Botërore ka dhënë shifrën 1.2 miliardë DEM në vit²⁶. Shkalla e rindërtimit në mbarë Kosovën është një nga treguesit e fondeve në zotërim të atyre fatlumëve që kanë të afërm jashtë Kosovës. Një tregues tjetër është numri i minibuseve (kombi) në Prishtinë – të sjella nga Gjermania nga anëtarët e familjes që vizitojnë Kosovën. (E njëjta gjë ndodh me veturat, numri i të cilave është rritur ndjeshëm prej qershorit 1999.) Kryeministri i qeverisë paralele të shqiptarëve të Kosovës, të vitit 1990, Bujar Bukoshi, në mbledhjen e fundit të Parlamentit të Republikës së Kosovës raportoi se nga 1991 deri në 1999 ishin mbledhur 1 miliardë DEM për të mbështetur strukturat paralele²⁷.

Me përjashtimin e shqiptarëve nga pushteti politik dhe ekonomik, mundësitë për korrupsion në nivel të lartë dhe të organizuar në vitet '90 ishin të kufizuara. Megjithatë, korrupsioni ka ekzistuar vazhdimisht dhe me ndërtimin e institucioneve të reja ai ka mundësinë të kthehet në tipar karakteristik. Bazë për këtë është përsëri rrjeti i krijuar mes grupeve politike dhe kriminale me interes të përbashkët kontrabandën e armëve, gjatë konfliktit të armatosur. Po kështu ka prova gojore se ka korrupsion mes punonjësve të administratës civile, të cilët p.sh. kërkojnë para për dhënien e formularëve të aplikimeve për vende pune në sektorin publik apo për dokumenta të tjera, si p.sh. dokumentat e udhëtimit²⁸. Ndonëse korrupsioni nuk mund të zhduket ai duhet mbajtur nën kontroll. Qëndrimi i zyrtarëve ndërkombëtarë ndaj këtyre veprimeve ndryshon nga mosmiratimi total deri në tolerim të konsiderueshëm, në varësi të përvojës në vendet e tyre.

Në media shpeshherë përmendet ekzistenca e mafias kosovare dhe lidhjet e saj me organizata të ngjashme në botë. Ekziston frika reale se këto organizata do të përfshihen aq vendosmërisht në ekonomi sa do të mund të kontrollojnë të gjithë territorin pas kalimit të pushtetit tek autoritetet vendore.

Duhet të gjenden rrugët për zbutjen e kriminalitetit. Zbatimi efektiv i ligjit është një hap shumë i rëndësishëm në mënyrë që njerëzit që bëjnë ankesa të jenë të sigurtë se drejtësia do të vihet në vend, dhe se do të garantohet siguria e tyre. Në këtë aspekt, zgjidhja e dështimeve të sistemit gjyqësor është përparësi urgjente. Përparësi tjetër është krijimi i një mjedisi ku do të jetë më e lehtë dhe më e dobishme të jesh i ligjshëm sesa i jashtëligjshëm.

Një burokraci transparente e cila nuk i mbingarkon bizneset (mallkim për ekonomistin socialist centralist); tatime që kuptohen me lehtësi dhe mblidhen me lehtësi në nivele të cilat lejojnë përfitime të arsyeshme; procedura efektive dhe energjike të revizionimit me masa ndëshkuese për ata që i shmangen sistemit – janë disa nga politikat të cilat mund ta ndihmojnë këtë proces. Për shumë biznese është më e thjeshtë dhe më e dobishme të jenë të ligjshëm, dhe nëse mundësia për t'u kapur është mjaft e lartë dhe ndëshkime të ashpra, atëherë të qënin të ligjshëm është rruga e vetme. Nëse sigurimi i jetesës në

mënyrë të ligjshme bëhet shumë i ndërlikuar, gjithmonë do të ketë një ngasje të fortë drejt metodave të paligjshme.

Shumica e shqiptarëve të Kosovës nga përvoja kanë mësuar të jenë dyshues ndaj pushtetarëve. Ky dyshim del qartë në qëndrimet ndaj policisë, që tradicionalisht ka qenë vegla e zgjedhës së shtetit. Janë inkurajuese disa raste së fundi, kur policisë i janë dhënë informata për zgjidhjen e disa krimeve. Megjithatë, rruga drejt besimit ndaj sistemit ligjor është ende e gjatë, sidomos në tejkalimin e shprehisë së heshtjes ballë hetimeve zyrtare. Kjo ndodh si në rastet e korrupsionit dhe mashtrimit po ashtu edhe në raste vrasjesh e përdhunimesh. Duhet të merren masa për rritjen e besimit tek sistemi ligjor, si p.sh. skema të mbrojtjes së dëshmitarit dhe viktimës pasuar nga fushata të informimit publik mbi dëmet që i shkakton shoqërisë shmangia dhe vjedhja e tatimeve. Deri tani, as UNMIK-u dhe as OSBE-ja, që është përgjegjëse për Shtyllën III të ndërtimit të demokracisë, nuk kanë ndërmarrë ndonjë fushatë publike të këtij lloji.

Shërbimi Doganor ka shkëlqyer në gjenerimin e të ardhurave në Kosovë, pavarësisht nga dhuna fizike dhe kërcënimet që u janë bërë zyrtarëve të këtij shërbimi. Shembull i kësaj është kërcënimi me vdekje që iu bë kryesuesit shqiptar të Shërbimit Doganor, dhe vizita që i bëri atij Shefi i Sigurimit të PDK-së ku i kërkoi të kthente në punë disa zyrtarë të larguar nga Pika Kufitare Doganore e Bllacës në kufi me Maqedoninë. Pas zëvendësimit të tyre me zyrtarë të tjerë të hyrat nga kjo pikë doganore u rritën me 40%²⁹. Doganat tani regjistrojnë mbledhjen e më tepër se 70% të akcizës dhe tatimit mbi karburantet³⁰.

Suksesi i Shërbimit Doganor është kryesisht rezultat i bashkëpunimit të fortë mes ndërkombëtarëve dhe vendorëve në trajnimin dhe zbatimin e rregulloreve mbi doganat. Misioni në Asistencë të Doganave, i themeluar nga Komisioni European, u vendos në Kosovë në gusht të vitit 1999. Ashtu si operacionet e tjera të ngjashme të Bashkimit European në Shqipëri dhe Bosnjë e Hercegovinë, misioni në Kosovë synon modernizimin e shërbimit doganor të UNMIK-ut dhe hartimin e praktikave doganore në përputhje me ato të Bashkimit European.

Megjithatë, pavarësisht nga suksesi në gjenerimin e të ardhurave, shërbimi doganor ka nevojë të

përmirësohet. Regjistrimi i saktë i importeve është vendimtar në zbatimin e TVSh-së që është në fuqi prej korrikut 2001. Shërbimi doganor duhet të pajiset me kompjutera të cilët duhet të vendosen në pikat doganore kufitare në mënyrë që zyrtarët doganorë të mos përdorin laps dhe letër për regjistrimin e të dhënave ditore që pastaj të shkruara me dorë dërgohen njëherë në javë në një kompjuter të vetëm për t'u procesuar.

Banka Botërore ka vënë në dukje mungesën e pikave të mbledhjes së taksave përgjatë kufirit me Serbinë, çka shkakton humbje të rëndësishme të të ardhurave nga inportet e paregjistruara të cigareve³¹. Një e përditëshme shkruante se 95% e cigareve të konsumuara në Kosovë futen në rrugë të paligjshme³². Hapja e këtyre pikave të mbledhjes së taksave, fillimisht e vendosur për në tetor 2000, u shty vazhdimisht nga UNMIK-u, duke nxjerrë si shkak arsyet politike – fillimisht zgjedhjet komunale të Kosovës (28 tetor 2000), më pas zgjedhjet parlamentare në Serbi (dhjetor 2000) e më pas Krishtlindjet Ortodokse (janar 2001). Po kështu, KFOR-i ka pasur probleme në lidhje me sigurinë, sidomos pas trazirave në Leposaviç, në fillim të dhjetorit 2000. Përfundimisht, pikat u hapën në mars 2001. Për ironi, hapja e pikave doganore në Serbi ndihmoi procesin e hapjes së pikave në Kosovë. Ky veprim i autoriteteve serbe, në thelb njihte Kosovën si një zonë të shkëputur doganore.

Një nga faktorët që e ve biznesin vendor në disavantazh të padrejtë është keqpërdorimi shumë i përhapur i një marrëveshjeje tregëtare me Maqedoninë. Për importet ekziston një tarifë e përgjithshme prej 10% , shtuar akcizën prej 15% për mallra të veçanta, duke arritur në një total prej 26.5%³³. Bazuar në një marrëveshje tregëtare mes RFJ-së dhe Maqedonisë në 1996, tarifa e importit të mallrave nga Maqedonia është vetëm 1%. Sipas një raporti të Bankës Botërore³⁴, kjo nxit falsifikimin e vendit të orogjinës në dokumentat që shoqërojnë mallin. Shpeshherë, kategorizimi i importeve nën origjinën maqedonase është fals. Tarifa prej 1% zbatohet edhe për mallrat kosovare që eksportohen në Maqedoni, por duke qenë se lëvizja e mallrave në atë drejtim është thujse zero, aktualisht, përfitimi nga kjo marrëveshje është i njëanshëm. Sidomos nga autoritetet maqedonase duhet të merren masa për ndalimin e keqpërdorimeve të tilla të kësaj marrëveshjeje tregëtare.

D. BUJQËSIA

Ndonëse pjesa më e madhe e aktiviteteve bujqësore është në nivele të ulëta apo thjesht për mbijetesë, sektorët e bujqësisë dhe agro-industrisë duke të përvijohen sipas një të ardhmeje afatgjatë dhe mjaft të fuqishme. Megjithatë, për realizimin e potencialeve dhe për kalimin e prodhimit në nivel të lartë, duhet të investohet në drejtim të përpunimit, marketingut dhe shpërndarjes (distribucionit). Asgjësimi prej forcave serbe i kafshëve dhe fshatrave, grabitja e pajisjeve dhe pasojat e tjera të konfliktit, përfshi edhe minimin e vendit, nënkupton një rimëkëmbje të ngadaltë të ekonomisë bujqësore kosovare.

Programi i Asistencës në Emergjencë, në periudhën 1999-2000, synonte të ndihmonte popullsinë rurale të rindërtonin jetët dhe ekonomitë e tyre. Përparësi ishin rifillimi i prodhimit të produkteve bujqësore bazë, mbrojtja e bagëtive dhe shtimi i kufizuar i numrit të bagëtive. Programi për Bujqësinë, në periudhën 2000-2001, pos të tjerash përfshinte vazhdimin e asistencës emergjente për rreth 20,000 deri 25,000 familje rurale të mbetura në gjendje të keqe. U morën masa për furnizimin e mjaftueshëm me fara, plehra dhe agro-kimikate, me një vlerë totale prej 130 milion DEM. 66 milion DEM janë shpenzuar ose duhet të shpenzohen në riparimin e makinerive bujqësore³⁵, më tepër se gjysma e të cilave u zhdukën gjatë konfliktit.

Kosova, që dikur plotësonte nevojat e veta për qumësht dhe mish, tani varet nga importi. Për të shpejtuar rimëkëmbjen e bagëtive, po zbatohet një skemë e importimit të kafshëve, me vlerë 24 milion DEM, e mundur kryesisht nga Zvicra dhe Banka Botërore. Një nga vështirësitë ishte se kanalet e mëparshme të distribucionit u dëmtuan nga dhënia falas e mallrave, çka ua bllokoi kapitalin tregëtarëve sepse natyrisht që bujqit parapëlqenin marrjen e mallrave falas. Ky ishte një shembull sesi mund të dështojnë synimet mirëdashëse të organizatave ndërkombëtare kur ato nuk këshillohen me vendorët.

Projektet për infrastrukturën përfshijnë rehabilitimin e sistemit të rrënuar ujitës dhe të kanalizimit. UNMIK-u ka qëllim që në tri vjet, 2001 – 2003, të investojë 92 milion DEM për rindërtimin e sistemeve të ujitjes dhe përtëritjen e

menaxhimit, bashkëpunimit mes fshatrave dhe mekanizmave rentabël. 80,000 hektarët e gjashtë skemave kryesore të ujitjes, mbulojnë sipërfaqen më të madhe të tokës më me vlerë, duke mundësuar kultivimin e produkteve më të shitëshme, si p.sh. perimet.

Pajisjet përpunuese janë më të vështira për t'u rivënë në punë, sepse krahas pasigurisë së lartë mbi sasinë dhe cilësinë e lëndëve të para si dhe konkurrencës nga importi kërkojnë investime në makineri,. Paqartësia mbi pronësinë shoqërore apo shtetërore të kompanive, çka shqyrtohet më poshtë, përbën një pengesë tjetër. Një nga kompanitë me aktivitet përpunimin ushqimor, është fabrika e birrës në Pejë, e cila në listat e punëtorëve përmban edhe emra punëtorësh nga fabrikat e panxharsheqerit, alkoolit industrial dhe fermentimit të birrës, që ishin pjesë e një kompleksi të tërë por që tani nuk janë aktive.

Përveç nxitjes së rimëkëmbjes, UNMIK-u duhet të fillojë ristrukturimin e sektorit bujqësor. Pronësitë e tokës arrijnë një mesatare prej 2.4 hektarësh, nga 0.5 deri 30 hektarë, ndonëse pronësitë e mëdha janë shumë të pakta. Sipas Departamentit të Rindërtimit, 40,000 deri 50,000 familje mbështeten në aktivitetin e vogël bujqësor, dhe 120,000 familje kanë bujqësinë një nga aktivitetet e tyre. Ndoshta 20,000 deri 30,000 ferma kanë mundësi suksesi, ndërsa pjesa tjetër mund të kenë vetëm aktivitet të vogël ose part-time³⁶. Kjo është pasojë e sistemit të trashëgimisë ku toka ndahet mes djemve të familjes, ndonëse në shumicën e rasteve një anëtar i familjes i administron të gjitha pjesët e tokës në emër të gjithë familjes, ndërkohë që anëtarët e tjerë merren me aktivitete të tjera. Toka ndahet në mënyrë të drejtë sipas cilësisë. Ndërkohë që lopët janë më të vlerësuarat, disa OJQ-ë po importojnë dhi sepse ato mbijetojnë në kushte më të ashpra. Duke qenë se fushat janë përgjithësisht të vogla, janë të pakta ato raste kur mund të përfitohet shumë nga përdorimi i makinerive.

Me pak fjalë, ka shumë bujq të vegjël që zotërojnë copa të vogla toke, prodhimi i të cilave nuk mund të konkurrojë me importin. Për rrjedhojë, shumë prej tyre thajse nuk prodhojnë fare dhe merren me tregëtimin e produkteve ushqimore të importuara. Fruta dhe perime të freskëta të kultivuara në Kosovë është shumë vështirë të gjenden. Një ekspert vendor ka pohuar

“Ne kemi tregun tonë, por ia kemi falur atë fqinjëve, ndërkohë që prodhimet tona kalben në bodrume”³⁷. Ka shënja të një prirjeje të ngjashme me atë në Bosnjë, ku të moshuarit dhe moshja e mesme po i kthehen tokës, për të jetuar një jetë me të cilën janë të mësuar, ndërsa të rinjtë po zhvendosen drejt qyteteve ose po emigrojnë. Prej përfundimit të konfliktit, ka pasur një lëvizje masive drejt qytezave dhe qyteteve, sidomos drejt Prishtinës.

Ashtu si për sektorët e tjerë, pamundësia për kredi të mjaftueshme është një pengesë serioze për zhvillimin bujqësor. Departamenti i Rindërtimit ka themeluar një Njësi të Zhvillimit të Agrobiznesit (NjZhA), e cila pos rolit këshillues dhe aftësues, zotëron një fond prej 20 milion DEM për përkrahjen e agrobiznesit dhe bujqve me mundësi suksesi komercial. NjZhA-ja ka edhe një fond tjetër prej 13 milion DEM për përkrahjen e prodhimit të farave dhe zhvillimit të kopshtarisë. Projektet janë të shumta. P.sh., fabrika e përpunimit të vajit vegjetal në Ferizaj kërkon t'u japë kredi bujqve për prodhimin e farave të lulediellit, të cilat do të përpunohen në këtë fabrikë. Bulmetoret e vogla i furnizojnë bujqit me koncentre, dhe do të donin t'i furnizonin edhe me lopë.

E. SERBËT E KOSOVËS

Aktiviteti ekonomik i serbëve të Kosovës, ashtu si edhe i shqiptarëve, bazohet kryesisht tek tregëtia dhe bujqësia e vogël. Varfëria e ekonomisë serbe duket qartë në brendësi të enklavave serbe. Mund të mësohet shumë gjëra tek kalon nga Mitrovica jugore tepër e rrëmujshme ku qarkullimi dhe parkimi janë pothuaj të pamundshëm dhe ku shenjat e ekonomisë private janë kudo, në pjesën veriore të kontrolluar nga serbët. Në këtë pjesë ka shumë më pak shitore të hapura dhe sasia e mallit që ato tregëtojnë është e kufizuar. Punonjësit serbë të administratës civile dhe mësuesit që punojnë në kuadrin e UNMIK-ut marrin dy rroga, një nga UNMIK-u dhe një nga Beogradi. Beogradi, në ndryshim nga UNMIK-u paguan ende pensionet dhe sigurimet shoqërore. Teorikisht, kjo do të thotë që së paku një pjesë e serbëve janë më mirë se çkanë qenë më parë, por për shkak të pasigurisë për të ardhmen, ata nuk shpenzojnë shumë.

Ekonomia e Mitrovicës, si për serbët ashtu edhe për shqiptarët, dikur varej nga kompleksi i minierave të Trepçes. Në ndryshim nga bumi i investime private shqiptare, përfundimi i prodhimit në Trepçe nuk ka sjellë nxitjen e iniciativave private mes serbëve. Bandat kriminale serbe i sigurojnë të ardhurat përmes futjes pa taksë të karburanteve dhe materialeve të ndërtimit nga Serbia për t'i shitur në mbarë Kosovën. Megjithatë kjo ka ndryshuar pas vendimit të UNMIK-ut për ngritjen e pikave rrugore të grumbullimit të taksave, vendim që shkaktoi konfrontime të dhunshme në maj 2001, por që e ndërpreu këtë lloj "tregëtie".

Po kështu, edhe dy enklavat e tjera janë në gjendje të përgjumur ekonomike. Shtërpcja/Sterpce, një zonë malore në juglindje të Prizrenit, ofron mundësi për turizëm në pushimoren e skijimit që ndodhet atje, e po kështu ofron mundësi për pylltarinë dhe rritjen e deleve. Megjithatë, qëndrimi i papajtuësëm i autoriteteve vendore komunale (tani të paligjshëm) ka shkaktuar që atje të mos ketë thujasë asnjë vizitor, dhe të gjitha vilat e pushimit dikur pronë e shqiptarëve dhe hotelet janë zënë nga serbët. Në Graçanicë, e cila është më e moderuar politikisht, ndodhen disa restorante dhe klube nate që janë nën kujdesin dhe frekuentohen nga zyrtarët ndërkombëtarë që punojnë në Prishtinën fqinje. Megjithatë, izolimi i këtyre enklavave të shkëputura nga njëra-tjetra ka shkaktuar cungimin e aktivitetit ekonomik.

Megjithëse krijohet përshtypja se serbët janë mbyllur në këto enklava, në të gjithë Kosovën ka fshatra të banuara nga serbët të cilët merren me aktivitetin tradicional të bujqësisë në nivel të ulët. Kjo popullsi aktivizohet sidomos gjatë organizimit të protestave dhe bllokimit të rrugëve në mbarë Kosovën.

Kjo shkëputje e kombinuar me shkallën e lartë të dyshimit shkaktuan që fillimisht shumë pak shqiptarë t'i mirëprisnin blerjet e serbëve të enklavave apo kontaktet tregëtare publike me ta. Megjithatë, arritjet modeste në qytete si Gjilani/Gnjilane, ku serbët kanë tezgat e tyre gjatë ditës së tregut, përbëjnë shkëndija shprese. Duke u nisur nga përvoja e Bosnjës, kontaktet tregëtare duhet të jenë ura e parë e rëndësishme për integrimin e këtyre dy bashkësive. Në të vërtetë, një tregëti e tillë ekziston mes veriut dhe jugut të Mitrovicës, shpesh me ndërmjetësinë

sidomos të boshnjakëve. UNMIK-u mund t'i nxisë këto kontakte duke kërkuar regjistrimin e çdo automjeti të Kosovës me targa të Kosovës. Aktualisht, shumica e serbëve kanë ende targat jugosllave, të cilat dallohen menjëherë dhe e kufizojnë jashtëzakonisht mundësinë e serbëve për të qarkulluar lirisht dhe pa rrezik.

Nxitja e kontakteve tregëtare mes serbëve dhe shqiptarëve nuk është vendimtare vetëm për uljen e varfërisë dhe të izolimit të serbëve të Kosovës. Ndonëse një rrugë modeste kjo do të ishte shumë e rëndësishme për zgjidhjen e problemit më të gjerë të krijimit të një mjedisi të sigurt për një shoqëri shumëetnike.

F. PRANIA NDËRKOMBËTARE

8,000 civilët ndërkombëtarë që ndodhen në Kosovë, kanë një ndikim të rëndësishëm mbi ekonominë. Rrogat në nivelin ndërkombëtar kanë pasojë inflacioniste, dhe ndodh shpesh që të ketë dy çmime, një për ndërkombëtarët dhe një për vendorët, siç ndodh me qiratë e ndërtesave në Prishtinë.

Krahasuar me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2001, prej 740 milion DEM, vetë UNMIK-u shpenzon rreth 1.2 miliardë DEM në vit. Megjithëse, natyrisht, që jo e gjithë kjo shumë hyn në Kosovë: pagat e stafit kalojnë në atë vend që vetë stafi e parapëlqen. Të hyrat e KFOR-it llogariten me vështirësi duke pasur parasysh politikën e ndryshme të Kombeve Kontribuese të Trupave, por ndikimi mbi pagat lokale është i ngjashëm me atë të shkaktuar nga UNMIK-u, OSBE-ja dhe BE-ja.

Krahas fuqisë blerëse të shumë ndërkombëtarëve që paguajnë qiratë, konsumojnë dhe përdorin shërbime, organizatat ndërkombëtare i shtrembërojnë kushtet ekonomike duke i dhënë stafit lokal rroga që janë përtej mundësive të ekonomisë vendore. UNMIK-u paguan shoferë, pastrues, roje, etj., me rroga mesatare 1,000 DEM në muaj, dhe disa deri në 2,000 DEM në muaj.

Në të kundërt, punonjësit e administratës civile të paguar nga Buxheti i Kosovës, ku përfshihen mësuesit, gjykatësit dhe punonjësit e Doganave dhe Policisë së Kosovës, marrin një rrogë prej 200DEM deri 1,000 DEM. Për pasojë, cilido që di qoftë edhe pak anglisht synon të punësohet nga

organizatat ndërkombëtare (kryesisht UNMIK-u, OSBE-ja dhe BE-ja), në dëm të shkollave, spitaleve dhe sektorit shtetëror në përgjithësi. Kur e pyetëm se si mendonte të rekrutonte staf cilësor në Strukturën e Përbashkët Administrative, kryesuesi ndërkombëtar i një institucioni u përgjigj: “Ata (kosovarët) mund të aplikojnë për një punë të dytë.”³⁸

Një çështje tjetër në lidhje me pagat e ulëta të zyrtarëve vendorë është edhe nevoja për t’iu kundërvënë korrupsionit. Krahas mundësisë së largimit të punonjësve cilësorë, pagat e ulëta nxisin korrupsionin në ato punë që janë më të ekspozuara ndaj tij. Në rastin e revizorëve vendas të AQF-së, zyrtarët ndërkombëtarë mendojnë se paga mujore prej 500 DEM do të nxisë motivimin dhe do të zbrapsë korrupsionin. Në rastin e zyrtarëve doganorë vendas, paga mujore prej 1,000 DEM synon të frenojë korrupsionin. Ashtu si në rajone të tjera të botës ku zyrtarët ndërkombëtarë punojnë krahas atyre vendorë dhe ku ekzistojnë dallime të mëdha në paga, duhet të vendoset një drejtpeshim, në mënyrë që punonjësit vendorë të nxiten për pjesëmarrje në institucione shtetërore, por pjesëmarrja e tyre të jetë e ndershme.

Për ta përmbyllur, Shërbimi Doganor ankohet se ndërsa është e vështirë të detyrohen tregëtarët vendas të zbatojnë ligjin, shumë shpesh edhe zyrtarët ndërkombëtarë që punojnë për UNMIK-un, KFOR-in, OJQ-të dhe nënkontraktorët e tyre, u shmangen detyrimeve ligjore. Sipas një burimi ndërkombëtar në sektorin doganor të UNMIK-ut, zyrtarët ndërkombëtarë janë të gatshëm t’i shpërfillin ligjet kur bëhet fjalë për mallrat apo projektet e tyre. “Ata po keqpërdorin privilegjin që gëzojnë për t’u përjashtuar nga taksat.”³⁹ Madje, edhe propozimi për një sistem zbritjeje që do të zbatohet për importe të ligjshme pa taksë doganore, u kundërshtua nga stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut.

III. STRATEGJIA NDËRKOMBËTARE

Elementët vendimtarë të strategjisë ndërkombëtare për rehabilitimin e ekonomisë kosovare mund të përmblihen si vijon:

- Ndhimja emergjente dhe rindërtimi
- Krijimi i një kornize institucionale
- Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm ligjor
- Komercializimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore
- Nxitja e sektorit privat

Për realizimin e këtyre detyrave, Shtylla IV e UNMIK-ut ka themeluar institucionet e mëposhtme në administratën ekonomike dhe financiare:

- Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK), “banka qendrore” e Kosovës, përgjegjëse për dhënien e licensave për institucionet financiare dhe për zhvillimin e një sistemi bankar për ekonominë e tregut.
- Departamenti i Rindërtimit, përgjegjës për mbikqyrje dhe bashkërendim të veprimeve të BE-së në Shtyllën IV.
- Autoriteti Qendror Fiskal (AQF), që përfshin thesarin, zyrën e buxhetit, administratën tatimore dhe shërbimin doganor.
- Departamenti i Shërbimeve Publike, përgjegjës për krijimin e shërbimeve serioze në një ekonomi tregu të plotësuar me një kornizë funksionale rregullash. Kjo përfshin krijimin e ofruesve funksionalë dhe të besueshëm të Shërbimeve Publike.
- Departamenti i Tregëtisë dhe Industrisë (DTI), me detyrë realizimin e komercializimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore, nxitjen e zhvillimit të sektorit privat, investimeve të brendshme e tregëtisë me jashtë.

Ashtu si BE-ja, e cila zyrtarisht ka mpër detyrë rimëkëmbjen ekonomike, USAID-i dhe kontraktorët e tij janë faktorë madhorë në fushën ekonomike. Kjo ka sjellë njëfarë acarimi mes disa punonjësve të BE-së dhe kontraktorëve të USAID-it, duke nxjerrë si shkak “mospërputhjet kulturore”. Përveç vendeve të BE-së dhe USAID-it, rendi i gjatë i vendeve që përfaqësohen në UNMIK, ka qenë një shkak tjetër për mosmarrëveshje⁴⁰.

Krahas problemeve objektive, pasojë e nivelit të ulët të ekonomisë kosovare, bashkësia

ndërkombëtare është përballur me ndryshime në këndvështrime mes anëtarëve të saj mbi çështje të tilla si shkalla e ndërhyrjes së shtetit. Përveç çështjes së përkrahjes së mirëqenies shoqërore, është edhe problemi i pronësisë shtetërore të korporatave, si telekomunikacioni, prodhuesit dhe shpërndarësit e energjisë, dhe ofrues të tjerë shërbimesh. Përgjithësisht, Shtylla IV e përkrah minimalisht drejtimin shtetëror të tyre. Biznesmenët dhe ekonomistët vendas, përgjithësisht, përkrahin një ekonomi tregu të lirë, ndonëse për nivelin e lirisë ka mendime të ndryshme, por mes brezave më të vjetër ka nga ata që nuk heqin dorë nga ideja për një rol të fortë të shtetit.

Debati mbi programin e kontabilitetit të zyrtarizuar për BPK-në, ishte shembulli tipik i problemeve që lindin për shkak të ndryshimeve mes punonjësve ndërkombëtarë që punojnë me kontrata afatshkurtra. Një program norvegjez për kontabilitetin, që u zbatua në 1999, shkaktoi shumë probleme sepse ishte tepër i ndërlikuar dhe i vështirë për t'u mësuar. Pavarësisht nga ankesat e shumta për këtë program, askush nuk ka përcaktuar nëse problemet janë pasojë e programit apo e gabimeve të përdoruesit. Disa zyrtarë ndërkombëtarë ankohen se vizioni afatshkurtër i kontraktorëve për të cilët Kosova është një ndalesë e shkurtër drejt misionit të ardhshëm, dëmton planifikimin efektiv afatgjatë⁴¹.

Dallimet kulturore ose në këndvështrime mes stafit ndërkombëtar, pasohen nga njëfarë mospërputhje në perceptime apo synime mes ndërkombëtarëve dhe "vëndorëve". Duke mos e pëlqyer mungesën e dëshirës së ndërkombëtarëve për t'u këshilluar me vëndorët e kualifikuar, disa shqiptarë kanë përshtypjen se ata kanë ndërruar një zot kolonialist me një tjetër, ndonëse ky i dyti më dashamirës. Ky perceptim është përforcuar nga pavëmendja e organizatave ndërkombëtare të përfshira në qeverisje për të zhvilluar aftësitë drejtuese vendore. Ndërkohë që UNMIK-u po e zvogëlon numrin e përfaqësuesve të huaj në administratën civile, janë të paktë punonjësit vëndorë të trajnuar dhe të gatshëm për të marë funksionet e stafit ndërkombëtar që po largohet. UNMIK-u duhet ta rishikojë politikën e tij e duhet t'i japë përparësi udhëzimit dhe trajnimit të zëvendësuesve vëndorë.

A. NDIHMA EMERGJENTE DHE RINDËRTIMI

Në vijim të hyrjes së NATO-s dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në Kosovë në qershor 1999, përpjekjet fillestare u përqëndruan në ndihmat emergjente. Përpjekjet e menjëherëshme për rindërtim nga vetë shqiptarët, e shkurtuan fazën e emergjencës, e cila duhet të kishte qenë e përqëndruar më tepër tek ata që kishin nevojë më shumë. Të mësuar me ndihmat emergjente në Bosnjë dhe në vende të pazhvilluara të botës së tretë, këto organizata e kuptuan me vonesë aftësinë e vetë shqiptarëve të Kosovës për të rifilluar, tek përjetonin për herë të parë lirinë. Gjithashtu, këto organizata ishin të pajisura për ndihmë emergjente dhe jo për zhvillim. Kjo solli që ndihma e emergjencës të kthehej në ndihmë për rindërtim dhe zhvillim vetëm në vitin 2000.

Shumat e mëdha që nevojiten për rindërtimin e infrastrukturës fizike të Kosovës duhet të jepen nga donatorët. Shtylla IV duhet të sigurojë përdorimin e drejtë të fondeve të dhuruara në kushtë të tilla ku ka shumë donatorë por ata nuk janë të detyruar të ndjekin përparësitë e parashtruara nga BE-ja. Bashkërendimi i donatorëve është përmirësuar qëkur vëllimi më i madh i punës kaloi nën kontrollin e agjensive qeveritare dhe OJQ-të e vogla të ndihmave të emergjencës u larguan⁴¹, por megjithatë dyzimet dhe mangësitë nuk janë zhdukur përfundimisht. Një shembull i veçantë ka qenë ndërtimi i shkollave, kur disa organizata mund të konkurronin në një fshat, ndërkohë një shpërfillej fshati fqinjë⁴³. Nevojat e mëdha për ristrukturim nënkuptojnë që edhe përmes shumave të mëdha që janë shpenzuar dhe po shpenzohen, nuk mund të arrihet më tepër se kalimi i infrastrukturës bazë në një nivel minimal të pranueshëm.

BE-ja ka udhëhequr përpjekjet për të siguruar materialet për rindërtimin e 120,000 shtëpive të dëmtuara nga lufta. Rreth 70% e fondeve të rindërtimit vijnë nga vendet anëtare të BE-së, që kryesisht veprojnë përmes Komisionit Europian. Si agjensi financuese e BE-së dhe e shkëputur nga Shtylla IV, Agjencia Europiane për Rindërtim (AER) është përgjegjëse për menaxhimin e programeve kryesore të ndihmës të BE-së në Kosovë. Gjatë 2000-2001, AER ishte përgjegjëse për 547 milion EURO⁴⁴. Me këtë shumë të madhe, AER pati përparësi rindërtimin e infrastrukturës së shpërfillur të Kosovës, duke u

përqëndruar tek energjia, strehimi, transporti dhe furnizimi me ujë si dhe tek projektet ndihmëse në bujqësi, zhvillimin e ndërmarrjeve, shëndetësi, dhe qeverisjen lokale/shoqërinë civile.

Nga fundi i 2000, BE-ja raportonte se ende mbi 40% të shtëpive të dëmtuara gjatë luftës (50,000 nga 120,000) kishin nevojë për riparime⁴⁵. Po ky raport theksonte se vetë shqiptarët i kishin paraprirë bumit të rindërtimit të shtëpive. “Shumica e atyre shtëpive që janë riparuar apo rindërtuar janë bërë nga vetë shqiptarët pa ndihmën e donatorëve⁴⁶.” Lulëzimit të rindërtimeve iu bashkangjiti edhe lulëzimi i ndërtimeve. Shumë shqiptarë po ndërtojnë më në fund “shtëpinë e ëndërruar” tani që nuk i tremben më rrezikut të humbjes së një investimi të tillë madhor (për shqiptarët të ndërtoje një shtëpi të madhe gjatë sundimit serb ishte si t’i kërkoje vetë problemet).

Për më tepër, ashtu si lartpërmendet, popullata në mbarë Kosovën po lëviz me shpejtësi nga zonat rurale në ato urbane. Një vlerësim i BE-së bënte të ditur se:

Ndërtimet e jashtëligjshme janë përhapur shumë, dhe kjo ndikon në zhvillimin hapësinor të Kosovës si një e tërë dhe në mjedisin e qyteteve dhe fshatrave. Kjo e ka shtuar shtypjen mbi infrastrukturën urbane edhe kështu të ngarkuar, përfshi furnizimin me energji dhe ujë, kanalizimet, mbledhjen e mbeturinave dhe transportin. Nuk ka autoritet qendror për të rregulluar planifikimin urban dhe hapësinor, dhe autoriteti i komunave në drejtim të një funksioni të tillë është i kufizuar ose i paqenësishëm. Rezultat i kësaj është zbatimi i parregullt dhe i gabuar i rregullave të planifikimit dhe ligjeve të ndërtimit. Pronësitë e pasigurta të pronave, përfshi edhe të shtëpive, i shtojnë edhe më tepër problemet. Të gjitha këto probleme duhet të shtrohen për zgjidhje në 2001⁴⁷.

Ashtu si vihet në dukje edhe nga ky vlerësim i BE-së, modelet e lëvizjes së popullsisë dhe ndërtimet e reja kanë pasoja të rëndësishme për rindërtimin e infrastrukturës. Rindërtimi i infrastrukturës së shpërfillur dhe të dëmtuar në fusha të tilla si rryma, furnizimi me ujë dhe

komunikacioni, përbën vështirësi shumë më të madhe sesa detyra realtivisht e thjeshtë e rindërtimit dhe riparimit të shtëpive të dëmtuara. Ka pakënaqësi të madhe ballë ngadalësimit në përmirësimin e këtyre fushave që shihet p.sh. në ndërprerjet e shpeshta dhe në vazhdim të rrymës apo kufizimet e furnizimit me ujë. Megjithatë, sfida e sigurimit të rrymës dhe e rindërtimit të një infrastrukture të përshtatëshme është e jashtëzakonshme. Në shumë aspekte, është ende herët të gjykohen arritjet e programeve të BE-së për infrastrukturën.

1. Telekomunikacioni

Një sektor i rëndësishëm që kërkon dyfishin e energjive nga bashkësia ndërkombëtare, është edhe telekomunikacioni. Shkalla e përhapjes së telefonisë para 1998 në Kosovë ishte vetëm 6 linja për çdo 100 banorë (e parafundit në Evropë). PTK-ja e zhvillon aktivitetin me humbje por ka pasur sukses në rritjen e të ardhurave përmes rrjetit Alcatel Mobile. Në 2001 u caktuan më tepër donacione (1.7 milion DEM) për “planifikimin, menaxhimin dhe financat” dhe shërbimin postar sesa për telekomunikacionin (210,000 DEM). Po kështu do të bëhet edhe gjatë 2002-2003, por gjithsesi mbetet nevoja e ngutshme për shërbime të besueshme të telekomunikacionit⁴⁸.

Koncesioni fitimprurës i telefonisë mobile, ngjalli mosmarrëveshje të mëdha mes udhëheqjes vendore të PTK-së dhe Komisionit të Përbashkët Civil (KPC) të UNMIK-ut, në lidhje me përzgjedhjen e kontraktorit. Vendimi i nëntorit 1999 për t’ia dhënë koncesionin Alcatel-Monaco-s dhe jo Siemens-it paralajmëroi për debatet që mund të lindin mbi përcaktimin e menaxhimit dhe pronësisë së ndërmarrjeve shtetërore dhe private. UNMIK-u vendosi për Alcatel-in pavarësisht nga përkrahja e fuqishme e menaxhimit shqiptar të PTK-së për Siemens-in.

“Unë e kuptoj që ata kanë të drejtë të na mbikqyrin – gjë që po e bëjnë – por jo të na ndalojnë dhe të marrin vendime për ne,” u shpreh në atë kohë Agron Dida, menaxheri i përgjithshëm i PTK-së. “Pronar i kësaj kompanie është populli i Kosovës dhe jo UNMIK-u.” Qëndrimi i UNMIK-ut ishte i ndryshëm, në përkrahje të vendimit të KPC-së pro Alcatel-it. “PTK-ja nuk është kompani private por publike. Pra KPC-ja ka të drejtat e një pronari që do të

ishin të barabarta me të drejtat e një aksioneri në një kompani private” u shpreh Pascal Copin, drejtori i UNMIK-ut për postat dhe telekomunikacionin. Dida tha, gjithashtu, se kundërshtimi i PTK-së për Alcatel-in buronte nga një plan për të përdorur një central kryesor i cili i kalon të gjitha thirrjet dhe sistemin e faturimit në Monako⁴⁹.

Alcatel-i është kritikuar vazhdimisht për tarifa të larta dhe shërbim të dobët. Biznesmenët lidhin tri ose katër kontrata telefonike (me Kosovën, Jugosllavinë, Maqedoninë, Malin e Zi) sepse tarifat me parapagim janë më konkurruese dhe kostoja e roaming-ut përmes Alcatel-it është tepër e lartë. Në 2003 do të ketë një proces të hapur tenderimi për rrjetin e telefonisë mobile në Kosovë.

2. Sektori i Energjitikës

Sfida më e madhe dhe më urgjente është sektori energjistik. Prej fillimit një nga prioritetet ndërkombëtare ishte rivënia në punë e rrjetit elektrik. I gjithë sistemi ishte i shkatërruar. Ish punonjësit shqiptarë kërkonin të riktheheshin në punë në KEK dhe punuan pa pagesë në kushte të tmerrshme për të rivënë në punë minierat e qymyrit dhe centralet e rrymës në zemër të sistemit pranë Obiliqit/Obilic. Menaxhimi i lartë i KEK-ut (i vetëmëruar me miratimin e Administratës së Përkohëshme) kishte ekspertizë të kufizuar dhe dije teknike të mbetura 10 vjet prapa.

DTI-ja krijoi një ekip këshillues të menaxhimit të kontratave, pa pushtet ekzekutiv, për të ndihmuar stafin vendor të organizonte rindërtimin dhe funksionimin e sistemit, çka nuk u pëlqye nga vendorët, dhe kjo u shoqërua nga disa mosmarrëveshje kontraktuale mes këshilltarëve dhe UNMIK-ut. UNMIK-u krijoi një Task Force të emergjencës për Shërbimet e cila u përpoq të vinte rregull në ndërprerjet e rrymës gjatë dimrit të ashpër 1999-2000. Gjendja e pajisjeve nuk lejonte planifikimin. Duke qenë se linjat kryesore prej 400kV ishin jashtë funksionimit dhe nuk lejonin importin e rrymës nga vende të tjera ballkanike, rryma u importua nga Serbia dhe në një sasi më të vogël nga Shqipëria, përmes linjave më pak efikente prej 220 kV. Një tjetër problem madhor i vazhdueshëm është se strategjia e nxjerrjes së qymyrit në periudhën e fundit të

kontrollit serb ishte tejet afatshkurtër me pasojë sasi të pakta të qymyrit në centralet e rrymës⁵⁰.

Mungesa e ekspertizës drejtuese mes stafit shqiptar solli kriza të shpeshta pasojë e mungesës së planifikimit për kimikate të rëndësishme për trajtimin e ujit dhe vajit për rrifillimin e gjeneratorëve duke bërë rifurnizime emergjente me këta artikuj me një kosto tepër të lartë. Gjatë 2000, një nga dy gjeneratorët u vendos në stacionin më modern Kosova B dhe u riparuan linjat e tensionit të lartë 440 kV. U bënë negociata për importimin e rrymës nga Bullgaria, Rumania, dhe vende të tjera fqinjë.

Kjo lejoi furnizim më të qëndrueshëm gjatë dimrit më të butë 2000-2001, gati dyfish më tepër karahsuar me dimrin e mëparshëm. Po kështu kjo u dha më tepër kohë minierave të qymyrit dhe stacioneve të rrymës për t'u rikthyer në njëfarë rregulli. Megjithatë, mosbesimi ndaj Serbisë u rishfaq gjatë negociatave për importimin e rrymës. Sistemi energjetik i Kosovës është projektuar, ndërtuar dhe ka funksionuar si pjesë e pandarë e atij të mëparshëm jugosllav, dhe të gjitha çelësat e importit kontrollohen nga Kompania Serbe e Rrymës (EPS). Kjo shkaktoi bojkotimin e diskutimeve nga menaxhimi i KEK-ut, derisa Shtylla IV i bindi ata se alternativa e vetme ishte edhe një dimër tjetër pa rrymë⁵¹.

Megjithë përparimet e arritura, rëniet e sistemit kanë vazhduar. Me përfundimin e rindërtimit të Kosova B furnizimi me rrymë do të jetë rreth 560-600 MW, shumë më tepër sesa kërkesa për rrymë gjatë verës dhe thuajse e mjaftueshme për konsumin dimëror. Por pas më tepër se dy vjetësh të qeverisjes ndërkombëtare problemet vazhdojnë ende, dhe Kosova A, megjithëse në të vërtetë është në fund të jetës së saj, duhet të zvarritet edhe për 5 ose 7 vite të tjera. Dy këshillues të pavarur kanë pohuar se kjo është e mundëshme dhe do të ishte zgjidhja më e mirë ekonomike. Në një afat të shkurtër do të jetë nevoja për ndërtimin e një centrali për prodhimin e rrymës si hap i përkohshëm derisa të ndërtohet një central me bazë linjiti.

Një nga pengesat e KEK-ut në funksionimin e tij është mospagimi i rrymës nga konsumatorët. Në një vend ku lidhjet e paligjshme të rrymës janë të zakonshme, ku ka lëvizje masive të popullsisë, ku matësi mund të mos ketë funksionuar për vite

të tëra edhe pse në adresë shkruhet emri i saktë i konsumatorit, organizimi i sistemit të faturimit do të jetë një sfidë e vështirë. Korrigjimi i kësaj situatë është një nga detyrat kryesore të UNMIK-ut në strategjinë për këtë sektor, dhe ndihmat e mëtejshme financiare për KEK-un varen nga rikthimi i të ardhurave në një nivel të pranueshëm. Kjo është një objektivë kryesore për menaxhuesin e ardhshëm të KEK-ut.

3. Transporti dhe Integrimi Rajonal

Pavarësisht nga përpjekjet për riparimin e rrugëve të dëmtuara, infrastruktura e transportit mbetet e papërshtatëshme në shumë zona, edhe kur e krahason me standartet rajonale. Ndërtimi i autostradave për momentin mbetet vetëm një ëndërr sidomos kur shumë rrugë janë tmerrsisht të dëmtuara. Lidhjet e dobëta të transportit përbëjnë një nga faktorët që pengojnë integrimin e Kosovës në ekonominë rajonale. Bizneset e Kosovës vuajnë edhe nga fakti se kamionat me regjistrim të Kosovës nuk mund të dalin nga Kosova, sepse targarat e tyre nuk njihen nga shumica e vendeve të rajonit, përfshi sidomos Serbinë dhe Maqedoninë që janë rrugët më të mundëshme për tregëtimin mes këtyre vendeve. Njerëzit i qasen këtij problemi ose duke nxjerrë dy lloj targash ose duke bërë ngarkimin e mallit në kufi. Bashkësia ndërkombëtare duhet të ushtrojë presion tek shtetet e rajonit për njohjen e targave të Kosovës si dhe të dokumenteve të udhëtimit.

Ekonomia kosovare e bazuar tek tregëtia dhe ndërtimi, prej 1999 është e përpirë nga importet, përfshi ato nga vendet rajonale si Maqedonia, Sllovenia dhe Kroacia. Mangësia e aftësisë prodhuese në dy vitet e paskonfliktit, shpjegon se pse bilanci tregëtar i kësaj province anon ndjeshëm nga importet, deficit i cili financohet nga të ardhurat prej diaspore dhe donacionet.

Një projekt rifillues që ia vlen të zbatohet, do të ishte sigurimi i një daljeje në det përmes Shqipërisë. Ka pasur propozime nga disa qarqe për ndërtimin e një rruge moderne drejt Durrësit, si një alternative e vlefshme ballë rrugëve ekzistuese drejt Maqedonisë dhe Malit të Zi⁵². Rruga ekzistuese u rrah aq shumë nga lëvizjet ndërkombëtare gjatë 1999, sa që NATO-ja i premtoi qeverisë shqiptare se do e rindëronte. Asgjë nuk është bërë deri tani. Mbylljet e fundit të kufirit me Maqedoninë në Bllacë/General

Jankovic ishin konfirmim i dobësisë së Kosovës ballë presionit të fqinjve. Rruga drejt Malit të Zi është e gjatë e ka kapacitet të ulët. Marë shkas nga trazirat e fundit në Maqedoni, UNMIK-u dhe BE-ja duhet të fillojnë plane serioze me Shqipërinë për variantin e rrugës drejt Durrësit, si një kontribut i rëndësishëm afatgjatë për normalizimin e Kosovës dhe për integrimin rajonal.

B. KORNIZA LIGJORE

Kushti themelor për investime është një shkallë e lartë dhe e qëndrueshme e sigurisë. Kjo nënkupton një mjedis të sigurt ndaj krimit, dhunës, trazirave dhe kërcënimeve, si edhe një kornizë të qartë ligjore e cila siguron mbrojtjen e të drejtave dhe zbatimin e detyrimeve. Pra, krijimi i një kornize të shëndoshë ligjore është parakusht për ndërtimin e një ekonomie të shëndoshë.

Në Kosovë, diskutimi mbi kornizën ligjore çon pashmangshmërisht tek çështja e statusit përfundimtar: a do të kthehet kjo provincë nën sovranitetin jugosllav, apo do të mëvetësohet tërësisht ose me kusht? Pasiguria e përgjithshme mbi këtë çështje pengon investimet serioze nga agjensi të brendshme apo të jashtme, sepse dyshohet në rikthimin e juridiksionit të Beogradit, i cili mund të mos i njohë marrëveshjet e bëra me UNMIK-un apo të drejtat e dhëna prej tij.

Për fillimin e investimeve serioze të brendshme apo të jashtme, duhet të sqarohet çështja e pronësisë – një çështje ngaherë e vështirë për shtetet ish-komuniste. Para se të shpresohet se investuesit do të marrin rreth 100 ndërmarrjet ish-shtetërore ose rreth 350 ndërmarrjet ish-shoqërore, atyre u duhet krijuar siguria për investimet që do të bëjnë. Më poshtë flitet më tepër për privatizimin.

Meqenëse çështja e një juridiksioni afatgjatë nuk është zgjidhur, lind nevoja për masa që do të garantonin pasurinë dhe të drejtat e investuesve. Nëse aktualisht disa çështje të pronësisë dhe juridiksionit nuk mund të zgjidhen, duhet të gjenden rrugë kreative për krijimin e një mjedisi ligjor të përkohshëm. P.sh. Banka Botërore e ka gjetur një zgjidhje për problemin se Kosova nuk është një shtet sovran. Meqenëse UNMIK-u u

krijua në bazë të një mandati të OKB-së, për Bankën ka qenë i mundshëm dërgimi i ndihmave.

Infrastruktura ligjore për aktivitetet komerciale po zbatohet gradualisht. Siç edhe është përmendur, procedurat e regjistrimit të bizneseve u zyrtarizuan në mars 2000⁵³, duke u lejuar komunave mbajtjen e tatimit për bizneset e vogla dhe administratës qendrore tatimin për bizneset e mesme dhe të mëdha. Prej dhjetorit 2000 janë nënshkruar rregullore mbi Kontratat për Shitjen e Mallrave, Investimet e Huaja, Pengjet dhe Organizatat e Biznesit. Në maj 2001u shpall rregullorja mbi TVSh-në në Kosovë, e cila hyri në fuqi në korrik. Masa të tjera u paraqitën në shtator dhe tetor 2001: një program pilot për tatimin mbi pasuritë e palujtshme, rregullore mbi siguracionet, masa kundër krimit të organizuar, rregullore e rtin e saj për Kosovën në 2000, Banka Botërore theksonte elementët thelbësorë të një kornize ligjore, e cila duhet të përcaktonte ligjet e konkurrencës dhe mekanizmat për zgjidhjen e konflikteve⁵⁵.

Masa të tjera në lidhje me biznesin janë Tatimi i Paragjykuar⁵⁶, Tatimi mbi Hoteleri, Ushqim dhe Pije⁵⁷, dhe Tatimi mbi Shitjet⁵⁸. Po kaq të rëndësishme ishin dhe akcizat e zbatuara për një numër mallrash⁵⁹. Këto nuk u quajtën detyrime doganore sepse mund të zbatohen edhe mbi mallra të prodhuara në vend. Kjo shmangu problemet e lidhura me statusin e Kosovës e „rrjedhimisht”, edhe ato në lidhje me të drejtën ligjore të UNMIK-ut për të tatuar mallrat e importuara nga Mali i Zi apo Serbia. Lista e mallrave përfshin duhanin, alkoolin dhe karburantet si dhe pijet joalkoolike, kafënë, telefonat mobilë, videoregjistruesit, antenat satelitore dhe televizorët.

Rëndësi të veçantë pati prezantimi i TVSh-së në korrik 2001. Të ardhurat mesatare mujore të gjeneruara nga TVSh-ja kanë qenë rreth 30milion DEM. Kjo shumë është më tepër se trefishi i të ardhurave të gjeneruara nga tatimi mbi shitjet i prezantuar në janar 2000, i cili u zëvendësua nga TVSh-ja⁶⁰. Nga këndvështrimi i konsumatorit dhe biznesit të mesëm, TVSh është parë si tatim i ndërlikuar dhe çoroditës. Megjithatë, pavarësisht nga këto probleme të rritjes, ashtu si edhe në ekonomitë e tjera tranzitore zbatimi i TVSh-së është një hap i rëndësishëm, më efektiv sesa tatimi mbi shitjet dhe në përputhje me Evropën Perëndimore.

Sfida më e vështirë është zbatimi i rregulloreve. Për këtë qëllim, AQF-ja ka trajnuar mbi 200 revizorë tatimesh, 90 nga të cilët punojnë në Prishtinë, detyra e të cilëve është të vërtetojnë nëse bizneset i zbatojnë rregullat e tatimeve. Këta revizorë të vijës së parë kombinojnë nxitjen e zbatimit të rregullave me dhënien e dënimeve që ua shkundin kujtesën atyre që u shmangen tatimeve. Shmangia fiskale dënohet me 50% të shumës totale të tatimit. Kjo mund të shkojë deri në 100% nëse revizori zbulon se nuk janë mbajtur regjistra apo libra llogarish. Për mosregjistrimin e fitimit, dënimi është 5% në muaj.

C. SEKTORI FINANCIAR

Përpjekja ndërkombëtare për zhvillimin e një sektori të shëndetshëm financiar, i aftë të plotësojë nevojat e një ekonomie moderne, mund të jetë ndihmuar nga rrënimi i sistemit të mëparshëm financiar në 1999. Ndryshe nga Bosnja, Kosova është thuar se e çliruar nga rudimentet e ndërlikuara të sistemit të vjetër jugosllav. P.sh., zëvendësimi i mekanizmit të mëparshëm shtetëror të pagesave, Byrosë Publike të Pagesave, ka qenë tepër i vështirë në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë. Në Kosovë, ku Byroja e Pagesave u mbyll në qershor 1999, bashkësia ndërkombëtare vendosi ndërtimin e një mekanizmi të ri. Ky sistem së bashku me Bankën Kombëtare të Kosovës, u përfshi në Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK), krijuar nga ish-kryesuesi i UNMIKU-t, Bernard Kouchner, në 17 nëntor 1999⁶¹.

Meqenëse Kosova përdor njësinë monetare të një vendi tjetër (Gjermanisë), BPK-ja nuk është përgjegjëse për politikën monetare. Përndryshe, ajo kryhen shumicën e funksioneve të një banke qendrore të tipit perëndimor. Ajo drejtohet nga menaxherë profesionistë. Përgjegjësia e saj kryesore është licensimi i bankave dhe institucioneve financiare. Po kështu, ajo ofron shërbime bankare dhe pagesash për entet publike, si dhe mundësimin e pagesave kombëtare dhe shërbimeve të tjera të pagesave për bankat e Kosovës. Deri në shtator 2001 ajo ka licensuar 6 banka tregëtare, dhe në pozicionin e rregullatorit bankar ajo monitoron nga afër aktivitetin e tyre. Në korrik 2001 BPK-ja raportonte për katër (atëherë) bankat tregëtare dhe institucionet e tjera

financiare jobankare të Kosovës shumën prej 47,929 milion DEM në kredi tregëtare në proces dhe shumën prej 507,035 milion DEM në depozita. Në tetor 2001, BPK-ja raporton se nuk ka pasur asnjë kredi të pakthyer në portfolion e cilësdo bankë⁶².

Banka e parë e licensuar ishte Micro Enterprise Bank (MEB). MEB-i mbështetet nga një konsorciim bankash dhe institucoinesh financiare europiane, dhe ka menaxhim perëndimor. Zyrtarish ajo u hap në 24 janar 2000. Deri në tetor 2001 në depozitat e saj ka pasur 200 milion DEM, të investuara kryesisht në letra me vlerw europiano-perëndimore. Programi i saj për kredi, bazuar në kreditë e vogla, është në përputhje me planin e saj të biznesit, megjithëse mund të zgjerohet më tepër në drejtim të dhënies së kredive në Kosovë duke pasur parasysh nivelin e depozitave.

Banka e Re e Kosovës, e financuar nga biznesi i Kosovës, mori licensë të plotë në 9 shkurt 2001. Anksioneri më i madh është një konsorcium i punonjësve të Kompanisë së Hoteleve dhe Turizmit të Kosovës, një ndërmarrje shoqërore e cila drejton Grand Hotel në Prishtinë, dhe hotele dhe restorante të tjera në këtë qytet. Një aksioner tjetër i kësaj banke është edhe fabrika e birrës në Pejë. Ndonëse fabrika e birrës në Pejë arriti të merrte kredi nga kjo bankë, aktualisht Banka e Re e Kosovës nuk jep më kredi për aksionerët e saj⁶³. Ky veprim i fabrikës së birrës në Pejë nxjerr në pah atë mendësi të raportuar së fundi nga Banka Botërore, dhe që e ka burimin tek praktikrat e Jugosllavisë komuniste:

Ka një prirje tek disa nga bankierët e vjetër të Kosovës, aktiviteti i të cilëve u ndalua gjatë viteve '90, për t'iu rikthyer praktikave të viteve '80, kur bankat ishin pronë e ndërmarrjeve. Kjo ka shkaktuar një orientim jokomercial të sistemit bankar, i cili mbështetej tek dhënia e kredive me miqësi, klasifikimet e rrema dhe pasiviteti, pasojë e së cilave ishte thjesht dhënia e kredive për pronarët e ndërmarrjeve që i kishin themeluar këto banka⁶⁴.

Në nëntor 2001, BPK-ja ishte në shqyrtim të tre aplikimeve të tjera për banka të financuara nga konsorciume të shqiptarëve të Kosovës. BPK synon të sigurohet që historia e tyre financiare

dhe politikat e tyre të jenë sa më të rregullta. Dhënia e kredive për huamarrës apo grupe huamarrësish, kufizohet në 20% të kapitalit bankar për t'u siguruar liquiditeti, dhe është ende në një nivel shumë të ulët (një maksimum prej 600,000 DEM për një kapitalizim prej 3 milion DEM). Po kështu, autoriteteve të Beogradit u është kërkuar zgjidhja e çështjes së kompensimit të fondeve të përvetësuar nga Serbia prej Bankës së Kosovës në 1991, por deri tani nuk shihet të ketë një zgjidhje të afërt.

Një pasojë negative thelbësore e të metave të sektorit bankar, është vështirësia që ndeshin bizneset private në marrjen e kredive. Si zgjidhje alternative për plotësimin e kësaj nevojë, në 22 tetor 1999 PSSP nënshkroi një Rregullore që autorizonte institucionet financiare jobankare të jepnin mikrokredi deri në 2,000 DEM për individë dhe biznese të vogla⁶⁵. Prej atëherë janë licensuar dhjetë institucione kreditore jobankare, thuajse të gjitha për mikrofinancë.

Faza pilot e një Projekti Rural Mikrofinanciar filloi në nëntor 2000 në Klinë dhe Vushtrri/Vucitern, duke ofruar shoqata kursimesh dhe kredish për fshatin, me synim zgjerimin në 72 shoqata që do të mbulonin 1/3 e fshatrave të Kosovës pas katër vitesh. Kapitali fillestar prej 4 milion DEM u siguroa prej Agence France de Developpement dhe BE-së, dhe do të pasohet nga 20.9 milion DEM për Fazën e Dytë dhe 25 milion DEM për Fazën e Tretë në 2003 e më tej. Banka Botërore dhe BE-ja po bashkëfinancojnë një program për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME/NVM) me një investim prej 20 milion DEM, që do të ketë synim përfshirjen e të gjitha këtyre ndërmarrjeve, përfshi ato të industrisë së lehtë, shërbimet me TVSh-ë të lartë dhe përpunimin e produkteve bujqësore.

Ndërkohë që shuma e kredive i përshtatet ndërmarrjeve shumë të vogla, kushtet e tyre përmbajnë një faktor risku dhe interesa mbi 15%, zakonisht 18%, dhe afat maksimal kthimi tri vjet. Është e kuptueshme se kjo mbështetje financiare plotëson vetëm një pjesë të nevojave. Në sektorin bujqësor, Njësia e Zhvillimit të Agrobiznesit mundëson dhënie e kredive me norma më tërheqëse – 9 deri 12%, me afat kthimi deri tetë vjet – nga një fond prej thuajse 60 milion DEM siguruar përsëri nga BE-ja.

USAID-i me një partner lokal – Fondin Financues të Biznesit Kosovar - po krijojnë një fond kredish për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Pas financimit fillestar, qëllimi është të kalohet gradualisht në fonde lokale. Ky fond do të administrohet mbi baza komerciale, me synim kreditë afatshkurtra nga 40,000 DEM deri 400,000 DEM dhe gradualisht do të kthehet në një bankë me shërbime të plota. Mungesa e nje sistemi bankar dhe kreditor të përshtatshëm dhe me kompetencë më të lartë, është pranuar si nga UNMIK-u ashtu dhe nga institucionet lokale të lidhura me biznesin, si pengesë serioze e zhvillimit komercial.

D. KOMERCIALIZIMI DHE PRIVATIZIMI

Deri në 1991 ekonomia e Kosovës ishte pjesë integrale e asaj të ish Jugosllavisë, madje pjesa më e varfër dhe më e pazhvilluar e saj. Industrializimi në këtë pjesë të Jugosllavisë filloi vetëm në mesin e viteve 1970. Ndërmarrjet shoqërore (NSH), të cilat ofronin pjesën më të madhe të punësimit përpara 1989, pothuajse nuk përfituan asnjë investim pas rënies së ekonomisë jugosllave në fillim të viteve 1980. Përveç kësaj një pjesë e mirë e pajisjeve më të vlefshme u zhvendosën në Serbi gjatë viteve 1990. NSH-të e Kosovës u orientuan në shërbim të tregut mbizotërues jugosllav. Një treg i cili u zhduk për shkak të luftrave prej vitit 1991 dhe për shkak të teknologjisë të vjetëruar. Pra ndërmarrjet e tilla janë dyfish të mangëta.

DTI-ja ka regjistruar një numër prej 350 NSH ose më tepër, me mbi 60,000 punonjës. Rreth gjysma e tyre janë ende “të punësuar” dhe gjysma tjetër në pushim pa pagesë. Dikur NSH-të drejtoheshin nga ata që punonin për to, por praktikisht ato drejtoheshin nga drejtues të Partisë Komuniste. Një e treta e tyre konsiderohen se kanë potencial për të ardhmen. Një e treta tjetër kanë asete me vlerë. Shpërfillja e vazhdueshme po e rrënon potencialin dhe vlerën e mbetur të tyre. Një e treta e mbetur konsiderohen të pavlera.

Një anketë e bërë me 192 NSH nga Riinvest nxori në pah se shumica e tyre operojnë shumë poshtë kapacitetit të tyre⁶⁶. Sipas kësaj ankete, faktorët kryesorë pengues ishin mungesa e financimit, teknologjia jokonkurrese, dëmtimet e shkaktuara nga menaxhimi i mëparshëm dhe

lufta, dhe nga pasiguria e UNMIK-ut në lidhje me pronësinë shoqërore. Nga 42,581 të punësuarit në kompanitë e anketuara, vetëm 24,662 (58%) ishin të punësuar aktivë, rreth 16,000 ishin në pushim pa pagim dhe 3,300 paguheshin megjithëse nuk shkonin në punë. Pagesa mesatare mujore ishte rreth 200 DM, e cila sipas këtij raporti, ishte rreth 2.3 herë më e vogël se sa ajo e punëtorëve në kompanitë private. Anketimi nxori në pah se shumica e kompanive (83%) ishin pro privatizimit. Vetëm 10% ishin kundër procesit të privatizimit. Nga ndërmarrjet private të përfshira në anketim, 78% përkrahnin privatizimin dhe ishin të gatshme të mernin pjesë në këtë proces edhe përmes blerjes së aksioneve.

Shumë nga NSH-të janë konglomerate me bazë të gjerë me asete të diversifikuara. Gjendja e tyre aktuale është pasojë e miqësive, shpenzimeve dhe menaxhimit të keq që u ngrit në nivele më të larta gjatë viteve të trazuara '90. Milosheviçi shpesh i shpërblenet përkrahësit e tij me paketa aksionesh të ndërmarrjeve shtetërore, dhe NSH-të e Kosovës nuk përbënin përjashtim nga ky rregull. Në këtë periudhë u bënë privatizime tepër të dyshimta përmes së cilave ndërmarrjet iu dhanë ihtarëve të Milosheviçit. Sot statusi i këtyre ndërmarrjeve është i paqartë. Edhe nëse privatizimi do të zbatohet për të gjitha këto ndërmarrje, bankat tregëtare nuk do të ishin të gatshme të jepnin kredi të mëdha, për shkak të mungesës të dokumentacionit të nevojshëm për përcaktimin e vlerës së tyre. Një ide e përhapur brenda DTI-së është se marveshjet e dyshimta mbi NSH-të që janë bërë në vitet '90 duhet të anulohen. Po kështu ata mendojnë se ligjet e pronësisë që janë gjykuar si të pazbatueshëm duhet të bëhen të pavlefshëm.

Problemi se si duhen trajtuar privatizimet e bëra në vitet '90 nxjerr në pah problemin më të gjerë të përcaktimit të pronësisë së NSH-ve. UNMIK-u e ndjen se ka mbetur peng politik i Zyrës të Këshilltarëve Ligjorë (ZKL) të PSSP. Shqetësimi kryesor i ZKL-së është të mos ndërmarrë veprime mbi privatizimin që do të zgjidhnin përfundimisht të drejtat e pronës, çka mund të shihej si paragjykim i statusit përfundimtar të Kosovës. Kjo mungesë e qartësisë mbi pronësinë e pasurive dhe aseteve të tjera në bizneset shtetërore apo shoqërore pengon shitjen e tyre.

Vështirësia në përcaktimin e pronësisë të ish ndërmarrjeve shoqërore ka shkaktuar një debat të gjatë brenda UNMIK-ut mbi mënyrat e zvogëlimit të përfshirjes së shtetit në sektorin shoqëror dhe shtetëror. DTI-ja ka nxitur opsionin e privatizimit të ndërmarrjeve, të ndarjes së asetëve të tyre apo të shpërbërjes së tyre. UNMIK-u ka përgjegjësinë e tutorit për t'i rivënë në punë këto ndërmarrje dhe për të moslejuar shpërdorimin e asetëve të tyre. Mosveprimi në lidhje me çështjen e NSH-ve do të kushtojë më tepër në të ardhmen duke qënë se asetet tyre janë duke u kalbur. Një ide cinike (dhe deri diku thjeshtuese) e shprehur nga një menaxher shqiptar në pritje të privatizimit ishte se “nëse UNMIK-u arrin të krijojë përshtypjen se NSH-të nuk kanë potencial, potenciali i tyre do të humbasë vërtet”⁶⁷.

Privatizimi është opsioni i parapëlqyer i DTI-së për NSH-të me potencial zhvillimi. Ndoshta duke përdorur legjislacionin në fuqi para ndarjes së ish Jugosllavisë, NSH-të e vogla dhe të mesme mund të kthehen në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, me 60% të kapitalit të vet për punonjësit dhe 40% për shtetin, në formën e një Agjencie Fiduciare (Trust) të Kosovës (AFK). Çdo investues i ri që fut kapital të ri mund të blerë aksione nga punonjësit apo mund të bëjë një marëveshje për ndarjen e pronësisë së aksioneve të reja, ashtu si në ekonomitë normale të tregut. Në disa NSH të cilat kanë rifilluar prodhimin nën menaxhimin e mëparshëm, punonjësit japin kontributin e tyre për një fond investimi. Një shembull i tillë është fabrika e birrës në Pejë, ku punonjësit dhurojnë 10% të rrogave të tyre.

Ky propozim është pritur me interes dhe skepticizëm nga UNMIK-u dhe OKB-ja në Nju Jork dhe jo vetëm për shkak të frikës së paragjykitimit të statusit përfundimtar të Kosovës. Ekipi ligjor i OKB-së nuk dëshiron të ndërmarrë veprime mbi bizneset të cilat do ta vinin OKB-në në përgjegjësi përpara pronarëve përfundimtarë, por ende të pacaktuar të këtyre bizneseve. Këshilltarët e ligjeve komerciale të DTI-së e kundërshtojnë mosveprimin dhe e shohin opsionin e AFK-së si një rrugë optimale në përmbushje të përgjegjësisë fiduciare të UNMIK-ut dhe në respektim të pretendimeve serioze që mund të lindin pas zgjidhjes së statusit përfundimtar. Negociata e vazhdueshme mes Shtyllave mund të çojnë në krijimin e rregulloreve paraprake të privatizimit, por duke

pasur parasysh përparësitë e ndryshme mes juristëve të OKB-së dhe DTI-së, dallimet është vështirë të zhduken.

Megjithatë privatizimi i NSH-ve nuk mund të presë zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Për t'i dhënë ekonomisë shtytjen e nevojshme, UNMIK-u duhet të nxisë privatizimin dhe në këtë mënyrë duhet të zgjidhë çështjet mbi të drejtat e pronësisë, çka është tepër e nevojshme. Për t'u ofruar investuesve të mundshëm sigurinë e nevojshme përpara se ata të rrezikojnë paratë e tyre, por pa paragjykuar statusin përfundimtar të Kosovës, UNMIK-u duhet të garantojë se zgjidhja e mundëshme e statusit të Kosovës do të përfshijë konfirmimin e vendimeve mbi privatizimin dhe të drejtave rrjedhojë e tyre, të siguruara gjatë administrimit ndërkombëtar.

Ndonëse shumë zyrtarë ndërkombëtarë mendojnë se privatizimi nuk është ilaçi magjik për ekonominë e Kosovës, ende rruga më e mirë për shumë NSH me potencial zhvillimi mbetet thithja e investimeve. Shumë investues janë përpjekur të ndikojnë në ndryshimin e politikës aktuale të mosveprimit. Por një interesim i tillë nuk mund të zgjasë përgjithmonë.

Për NSH-të e tjera me asete të vlefshme, është e këshillueshme që ato të ndahen në njësi më të vogla dhe t'u jepen pronarëve të rinj me vlerën e tregut. Ky opsion është veçanërisht i përshtatshëm për konglomeratet karakteristike në Kosovë, asetet e një pjese të të cilëve mund të jenë ende të vlefshme ndonëse një pjesë e biznesit është e vdekur. Për disa NSH që konsiderohen të vdekura, zgjidhja më e mirë është falimentimi, ku mbetja e asetëve do të mbahej nga AFK-ja.

Ndonëse privatizimi është opsioni i parapëlqyer i DTI-s, në mënyrë që të kapërcehen pengesat ligjore që pengojnë privatizimin e menjëhershëm, DTI-ja ka propozuar “komercializimin” si një fazë e përkohshme e ringjalljes së NSH-ve. Kjo qasje nënkupton mundësimin e kontratave menaxheriale me kompanitë që aktualisht veprojnë në sektorët përkatës. Kjo lejon përdorimin e asetëve për një kohë të pacaktuar dukë mos paragjykuar pronësinë përfundimtare. Kontratat, të cilat do të ishin 10 vjeçare, kërkojnë që ofertuesi i përzgjedhur të investojë një shumë të caktuar për rifillimin e prodhimit dhe pastaj të

marrë drejtimin e ndërmarrjes. Kontrata e parë për nënshkrim ishte ajo për fabrikën e çimentos Sharri pranë kalimit kufitar me Maqedoninë, ku Holderbank ka premtuar investimin e 32 milion DEM gjatë 10 vjetëve të kontratës.

Në vijim janë nënshkruar edhe disa kontrata të tjera komercializuese. Në fillim të marsit 2001 tenderi për Thertoren e Prizrenit u fitua nga kompania prishtinase Fructus, e cila do të investojë 5 milion DEM në pajisje, 1.2 milion DEM në tri vitet e para të kontratës. Fructus është një nga ndërmarrjet e para private në Kosovë (1989, aktiviteti i së cilës është shitja me shumicë dhe pakicë e mallrave ushqimore në gjithë Kosovën⁶⁸. Aktualisht, DTI-ja po përgatit kompani të tjera për komercializim. Deri në fund të 2001 mendohet se investimet e premtuara nga kompanitë komercializuese do të arrijnë më tepër se 100 milion DEM⁶⁹.

Ndërkohë që kontratat komercializuese janë një rrugë efektive për rikthimin e veprimtarive të braktisura, numri i vendeve të punës të krijuara aktualisht nga këto kontrata llogaritet të jetë rreth 2,500. Kjo përbën vetëm 1.8% të numrit të punëtorëve të NSH-ve në 1999. Pra komercializimi është vetëm një alternativë e dobët e privatizimit.

1. Rasti i Trepçes

Një çështje me rëndësi të madhe, si politike ashtu edhe ekonomike, është konglomerati i Trepçes. Ai përbëhet nga rreth 40 miniera dhe fabrika kryesisht në Kosovë por edhe në Serbi e Mal të Zi. Aktivitetet e këtij konglomerati janë aq të shumëllojshme sa arrijnë deri tek përpunimi kimik i mallrave dhe prodhimi i baterive e bojës. Zemra dhe burimi i lëndëve të para më kryesore është kompleksi i gjerë i minierave në lindje të Mitrovicës. Gjendja e këtij konglomerati është shumë e rënduar nga menaxhimi i keq dhe mungesa e investimeve.

Trepça ka marrë një rëndësi shumë të madhe simbolike për shqiptarët dhe serbët, gjë që ndoshta e ka zmadhuar rëndësinë e saj ekonomike, kështu që çështja e marrjes së saj në kontroll ka një rëndësi të jashtëzakonshme simbolike. Për këtë arsye UNMIK-u ka mbajtur një qëndrim më kontrollues se ndaj ish-NSH-ve të tjera, duke u përfshirë direkt në çështjet e këtij kompleksi.

Veprimet e Milosheviçit shkaktuan një pështjellim të madh në lidhje me pronësinë e këtij kompleksi. Kjo mund të jetë bërë me qëllim për të shfrytëzuar pasuritë e kompleksit, për t'iu shmangur sanksioneve ndërkombëtare, për të fshehur rrjedhjen e parave, për të shpërblyer miqësitë dhe ndoshta për pastrimin e parave.

Qëndrimi i UNMIK-u është se sipas Rezolutës 1244 i takon atij përgjegjësia e plotë ligjore për mbështetjen e ristrukturimit të infrastrukturës kyçe dhe aspekteve të tjera ekonomike. Kjo i ngarkon UNMIK-ut mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e Trepçës, por ai nuk pretendon pronësinë fizike të aseteve të Trepçes, dhe nuk vendos për pronësinë apo kompensimin e dëmeve në të kaluarën, një pjesë e të cilave janë aktualisht çështje gjyqësore në vende të ndryshme.

Për më tepër, UNMIK-u ka të drejtën e pretendimit ligjor ndaj një pronari të mundshëm për shpenzimet e pastrimit që e kanë burimin tek praktikat e vjetra të prodhimit dhe tek ndotja e shkaktuar, shpenzime të cilat mund të jenë më të mëdha se edhe vetë vlera e kompleksit. Një gjobë tjetër me të cilën pronari i mundshëm mund të përballet është përgjegjësia për problemet e shëndetit shkaktuar ndaj punëtorëve dhe të tjerëve nga ndotja që kanë shkaktuar fabrikat. Në fillim të 200, i financuar nga USAID-i ,një kontroll ambientalist i gjashtë minierave, tri pikave të grumbullimit dhe dy shkretoreve, arriti në përfundimin se ato kishin shkaktuar degradim të thellë dhe të gjerë të mjedisit.

Faktet mbi ndotjen me plumb të shkaktuar nga shkretoria e Zveçanit e drejtuar nga serbët, dhe refuzimi i menaxhimit të RMHK TREPCA për të bashkëpunuar me UNMIK-un për zgjidhjen e këtij problemi, i dhanë KFOR-it dhe UNMIK-ut justifikimin politik për ta marrë në kontroll fabrikën, në 14 gusht 2000. Drejtorit të emëruar nga Milosheviçi iu ndalua hyrja në Kosovë, dhe 2,300 punëtorëve serbë që punonin atje iu caktua menjëherë nga UNMIK-u rroga mujore prej 60 DEM (ka rëndësi fakti që pagesa është bërë në Marka dhe jo në Dinarë). Pas disa ditë demonstrimesh, qetësia u rivendos, dhe UNMIK-u kishte mundësi të fuste në minierë këshilltarët inxhinierikë dhe ambientalë.

UNMIK-u ka siguruar njëfarë mbështetje përmes donacioneve të Agjensisë Europiane për

Rindërtim dhe Holandës, për pastrimin madhor të mjedisit që është një nevojë e menjëherëshme. Duke pasur parasysh pësjtjellimin mbi pronësinë, pasigurinë e lidhur me statusin përfundimtar dhe detyrimet e pashlyera, sigurimi i një të ardhmeje për disa nga përbërësit e konglomeratit të Trepçes është veçanërisht problematik. Opsioni i parapëlqyer nga UNMIK-u është të nxitë të gjithë aksionerët të nënshkruajnë një marrëveshje që do të mundësonte komercializimin përmes kontratave të lizingut, që do të ishte më mirë se një procedurë e zgjatur falimenti. Borxhet dhe detyrimet aktuale do t'i mbeten pronarëve të ligjshëm, të cilët mund të identifikohen nga një gjykatë kompetente.

IV. INVESTIMI NË NJERËZ

Perspektiva afatgjatë e ekonomisë bazohet në përdorimin sa më të mirë të burimit më prodhimtar të provincës – njerëzve. Për shkak të prapambetjes së ekonomisë Kosovare dhe të paaftësisë së saj për të tërhequr popullsinë që është në rritje të shpejtë – përveç vështirësive të jetesës në keqsundimin serb – emigrimi, i përkohshëm apo më afatgjatë, ka qenë mundësia e vetme për një pjesë të madhe të kosovarëve për të pasur një jetesë të sigurt. Ky emigrim ka qenë kryesisht i formës së punëtorëve vizitorë në vendet e Evropës Perëndimore. Kjo metodë ka gjasa të vazhdojë edhe për njëfarë kohe.

Përveç kësaj një pjesë e rëndësishme e të ardhurave vijnë nga diaspora. Duke pasur parasysh mungesën e popullsisë vendase në moshë pune në vendet ku ndodhet diaspora kosovare, sidomos në Evropën Perëndimore, ndryshimi i statusit të punëtorëve kosovarë në këto vende, mund të kishte përfitim për të dyja palët. Për të siguruar qëndrueshmëri më të lartë shoqërore, anëtarët e afërt të familjeve (bashkëshorti/ja, fëmijët) duhet të lejohen t'i shoqërojnë punëtorët në këto vende.

Një rëndësi të veçantë në krijimin e perspektivave për të punuar në mënyrë produktive brenda Kosovës, ka përmirësimi i kushteve të arsimit. Kosova ka nevojë për një sistem arsimimi të aftë të përgatisë njerëz sipas kërkesave të ekonomisë bashkëkohore. Kjo merr rëndësi të veçantë për faktin se 50% e shqiptarëve të Kosovës janë nën moshën 22 vjeçare⁷⁰. Ka shumë nevojë për ndryshime në programet shkollore dhe nuk duhet të vazhdohet t'u jepet rëndësi arteve liberale, një karakteristikë kjo e arsimit të lartë gjatë viteve '70 dhe '80. Kosovës i duhen inxhinierë, teknikë dhe menaxherë të aftë. Trajnimi dhe shkollimi i të rriturve është jetik për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Një nga pasojat e drejtimit të mëparshëm të centralizuar të ekonomisë, i theksuar edhe më tepër gjatë aparteidit të Beogradit filluar në 1990, është mungesa e menaxherëve të aftë, në drejtimin e personelit, në kontabilitet, marketing, planifikim strategjik dhe në drejtimin e kompanive. Siç është përmendur, aftësitë teknike janë një dhjtëvjeçar prapa. Shtojti këtyre mangësive në dije, një sistem arsimor të bazuar

kryesisht në të mësuarin mekanik (përmendësh), me metodologji instruktive dhe jo eksplorative, me drejtorë shkollash të emëruar për arsye politike, është e qartë se ka nevojë për korrigjim difektsh madhore strukturale.

Nuk bëhet fjalë vetëm për shkollimin e studentëve, por për shkollimin e atyre që përgatisin mësues. P.sh. në departamentin e kompjuterave, në Universitetin e Prishtinës, mësohet ende Fortrani – i dalë kohe dhjetë vjet para – sepse ligjëruesit nuk njohin programe të tjera. Numri i studentëve në klasa është një faktor tjetër. Ndonëse mesatarja e klasave në provincë është 20 studentë, në qytetet e mëdha ky numër arrin në 40 vetë ose më tepër. Mungesa e mjediseve është e zakonshme, pavarësisht nga një program madhor ndërtimesh, dhe kjo ka çuar në mësimin me ndërrime ku disa studentë e fillojnë mësimin në orën 7, në mëngjes, dhe të tjerë e mbarojnë në 8 ,në mbrëmje⁷¹.

Kjo gjendje u kuptua nga UNMIK-u , i cili në fillim të 2000 filloi një program strategjik të quajtur Zhvillimi i Sistemit Arsimor në Kosovë (ZhSAK), për ngritjen e një sistemi arsimor të njësuar dhe gjithëpërfshirës. Grupet e punës të ZhSAK shtriheshin në kopshte, në sistemin parashkollor, në ciklin e ulët, në arsimin e lartë dhe në institucionet hulumtuese. ZhSAK-u mer pjesë në shumë projekte që mbulojnë fushat e sipërpërmenduar si dhe arsimin profesional, ndonëse financimi për shumë nga këto fusha ende nuk është siguruar. Në 2000 u propozua një program trajnimi për 600 mësues aktualë të ciklit të ulët dhe të mesëm, të cilët dijet e fituara nga ky trajnim do t'ua përcjellin 22,000 mësuesve të tjerë. Trajnimi i mësuesve është financuar për vitin 2001 por ende jo për të trija vitet e palnifikuara. Një propozim i vitit 2000 për ndërtimin e një laboratorit të madh qendror në Universitetin e Prishtinës, me vlerë 15 milion DEM, dhe për pajisjen e shkollave të mesme me kompjutera dhe laboratorë shkencorë, nuk është zbatuar ende.

Planet e shpallura rishtas për hapjen e një dege në Kosovë të Universitetit Amerikan të Bullgarisë, nëse do të realizoheshin, do të përmirësonin ndjeshëm alternativat arsimore të studentëve kosovarë. Kjo degë do të quhet Kolegji Amerikan në Kosovë, dhe do të ofrojë kurse të pranuar në Amerikë dhe diploma dyvjeçare (associate's degree) dhe katërvjeçare (bachelor's degree).

Financimi do të bëhet nga "burimet e brendshme dhe të jashtme të kosovarëve, të cilët janë të gatshëm t'i përkushtohen këtij projekti dhe të bashkëpunojnë me UNMIK-un dhe Universitetin e Prishtinës për të ngritur një kolegji që do t'u shërbente nevojave të Kosovës⁷²." Strategjia e Shteteve të Bashkuara për gjetjen e fondeve lokale synon shmangien e shkurtimeve të donacioneve ndërkombëtare për Universitetin e Prishtinës.

Arsimimi zuri 27% të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2000 dhe 37% të buxhetit të rrogave dhe shërbimeve në vitin 2001. Duke pasur parasysh karakteristikat moshore të popullsisë, gjendja e shkollave do të vazhdojë të jetë e vështirë edhe gjatë pesë vjetëve të ardhshme, me pasoja që do të ndihen edhe në punësim.

Në të ardhmen, rritja e urbanizimit dhe mundësisht ulja e varfërisë rurale, do ta ulin numrin e lindjeve në nivele më të përbalueshme. Një fushatë e vazhdueshme edukuese është e nevojshme për ta bindur fshatataresinë shqiptare se ,përkundër besimit të ngulitur thellë, familjet e mëdha nuk i lehtësojnë vështirësitë ekonomike, por përkundrazi e dëmtojnë ardhmërinë ekonomike dhe tani edhe atë politike, duke ushtruar një shtypje të madhe në të gjithë strukturat e shoqërisë⁷³.

V. PËRFUNDIME

Ekonomia e Kosovës në disa aspekte është në gjendje më të mirë se ekonomitë e vendeve fqinjë. Ajo ka një njësi monetare të qëndrueshme. Lufta e saj ishte më e shkurtër, më pak e përgjakëshme dhe më pak shkatërruese se ajo në Bosnjë. Shumë refugjatë (natyrisht jo serbë) u kthyen menjëherë pas luftës. Rindërtimi i pasluftës pati ritme më të shpejta se në Bosnjë. Në ndryshim nga Maqedonia dhe Serbia, industritë më problematike ,ato shtetërore, jane kryesisht të mbyllura, dhe nuk ka gjasa të rihapen, duke ia hequr një barrë qeverisë së ardhshme.

Megjithatë, vartësia e plotë e provincës nga importet dhe infrastruktura e pazhvilluar dhe e dëmtuar (energja, telekomunikacioni, rrugët, uji) përbëjnë një sfidë të vazhdueshme. Papunësia është një problem serioz, dhe mbart rrezikun që një pjesë e të rinjve mund t'i kthehen përsëri politikës nacionaliste apo dhunës ballë mungesës së mirëqënies dhe një të ardhmeje të paqëndrueshme.

Ekonomia e Kosovës varet kryesisht nga remitancat e emigracionit, kryesisht nga Evropa, si dhe nga ndihmat ndërkombëtare dhe konsumi i ndërkombëtarëve. Shumica e aktiviteteve bazohen në shpenzimet e konsumatorëve dhe në ndërtim. Ndërkohë që bizneset e vogla, bazuar në paratë e diasporës dhe frymën e jashtëzakonshme sipërmarrëse, kanë lulëzuar në bumin fillestar të pasluftës, e ardhmja e tyre vështirësohet nga probleme si pamundësia e marrjes së kredive me interesa të arsyeshme.

Një problem madhor është kalimi pjesës më të madhe të ekonomisë joformale në sektorin e ligjshëm. UNMIK-u ka arritur njëfarë suksesi në regjistrimin e bizneseve dhe në hartimin e një sistemi tatimor që nxit biznesin. Megjithatë, ekziston nevoja për veprime më të ashpra ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, shoqëruar me procedura efektive revizioni të mbështetura nga një polici financiare dhe dënime të ashpra ndaj shkelësve të ligjit.

Suksesi i përpjekjeve për të rindërtuar dhe ristrukturuar ekonominë kosovare, do të jetë vazhdimisht i kufizuar nga refuzimi i ndërkombëtarëve për të cekur zgjidhjen e statusit

përfundimtar të Kosovës. Pavarësisht nga energjia e sektorit privat përfaqësuar nga ndërmarrjet e vogla, zhvillimi afatgjatë kërkon investime madhore që nuk mund të realizohen për sa kohë mbetet e pazgjidhur çështja e juridiksionit. Siç përmendet edhe në këtë raport, privatizimi i ndërmarrjeve ish-shoqërore pengohet nga shqetësimi i UNMIK-ut për të mos marë vendime që mund të shiheshin si paragjykim i statusit përfundimtar të Kosovës. Kjo përbën një arsye tjetër për zgjidhjen sa më të shpejtë të statusit të Kosovës.

UNMIK-u duhet të pranojë përgjegjësitë e tij fiduciare për të siguruar se asetet ekonomike me vlerë nuk do të lihen të kalben dhe të humbasin. Në mungesë të një vendimi për statusin përfundimtar duhet të zbatohen marrëveshje kreative për përcaktimin e një kujdestari të NSH-ve përmes DTI-së .

Jeta ekonomike është ndërprerë në mënyrë të ashpër në 10 vjetët e fundit. Shpërfillja e regjimit të Milosheviçit ndaj nevojave afatgjata të Kosovës, së bashku me vitet e sanksioneve ndërkombëtare ndaj Jugosllavisë, rezistencën paqësore të shqiptarëve, sistemin paralel gjatë viteve '90 dhe dhunën e viteve '98, '99, e kanë lënë gjurmën e tyre. Në rrethana të tilla, të bëje biznes të ligjshëm ishte e pamundur për shumicën e shqiptarëve. Të punoje jashtë ligjit ishte një mënyrë jetese dhe domosdoshmëri si dhe një qëndrim politik. Elementët kriminalë përfituan nga kjo për t'u furnizuar me të gjitha mjetet , përfshi dhe armët. Në mjedisin përgjithësisht të paligjshëm që mbizotëronte, banda të tilla kriminale zunë pozicione të fuqishme në shoqërinë kosovare, dhe shpesh u përzien me grupet e armatosura në luftë kundër sundimit serb.

Kur administrata ndërkombëtare mori kontrollin në vitin 1999, një nga sfidat e saj më të mëdha ishte lufta kundër elementëve kriminalë. Është e nevojshme të ndërmerren veprime më të ashpra për sigurimin e kufijve të Kosovës si dhe hapa për thmelimin e një sistemi gjyqësor efektiv. Lufta kundër krimit të organizuar do të ketë sukses të kufizuar nëse nuk u jepet një rol më i fuqishëm vendasve në zbatimin e ligjit. Kështu, nevoja urgjente janë trajnimi i policëve kosovarë dhe i gjykatësve në teknikat e hetimit. Një përbërës jetik i luftës kundër krimit është

përpjekja e UNMIK-ut për nxitjen e bizneseve për t'u regjistruar dhe funksionuar ligjërisht.

Një masë tjetër shumë e vlefshme do të ishin fushatat e informimit publik për ta nxitur popullin për t'i parë forcat e ligjit dhe të rendit si mbojtësit e tij dhe jo si vegla të shtypjes. Njerëzit duhet të binden për dëmin që i shkaktojnë shoqërisë së tyre elementët e korruptuar dhe kriminalë.

Mundësia e pakët për marrjen e kredive është faktori më i rëndësishëm që ndalon zgjerimin dhe rindërtimin e bizneseve vendase. Aktualisht pjesa më e madhe e aktivitetit ekonomik sillet rreth mallrave të importuara të konsumit. Pjesa më e madhe e industrisë metalpunuese, që ka qenë pjesa më e rëndësishme e ekonomisë së mëparshme të Kosovës, do të mbetet e braktisur për shkak të vjetërimit të teknologjisë së saj dhe humbjes të tregut të saj të mëparshëm jugosllav. Ekziston nevoja për industri të tjera. Një zgjidhje do të ishte investimi në bujqësinë e vogël e cila kërkon financime në përpunim ushqimor dhe bulmetet si dhe në përmirësimin e infrastrukturës bujqësore.

Problemet e ekonomisë kosovare janë më tepër se thjesht rindërtimi i pasluftës. Mungesa e investimeve për dekada të tëra e ka lënë pjesën më të madhe të ekonomisë të rrënuar. Arsimimi, sidomos në formën e trajnimit profesional, do të jetë një faktor vendimtar për zhvillimin afatgjatë të ekonomisë dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Lulëzimi i tregëtisë dhe ndërtimit ka kufizime të dukshme. Kjo nuk mund të zgjidhë problemet strukturore të ekonomisë. Një pjesë e madhe e popullsisë vazhdon të jetojë në varfëri. Mbështetja në remitancat e emigrantëve dhe donacionet pasqyron mangësitë e kapacitetit të brendshëm të ekonomisë kosovare. Megjithatë, ka mundësi të mëdha për përparim nëse krijohet një mjedis i lirë për privatizim, investim dhe ristrukturim; nëse ndalet korrupsioni e krimi dhe përmirësohet arsimimi; nëse normalizohen marrëdhëniet e Kosovës me fqinjët e saj dhe ekonomia integrohet me rajonin; nëse UNMIK-u gjen forca të përparojë me privatizimin; dhe nëse zgjidhet çështja më e rëndësishme politike, ajo e statusit përfundimtar të Kosovës.

Prishinë/Bruksel, 19 dhjetor 2001.

SHËNIME SHPJEGUESE

1 Katër Shtyllat e UNMIK-ut janë: I. Humanitare, e udhëhequr nga UNHCR; II. Administrata Civile e udhëhequr nga UN; III. Themelimi i Demokracisë, i udhëhequr nga OSCE; IV. Rindërtimi, Ristrukturimi dhe Zhvillimi Ekonomik, i udhëhequr nga EU.

2 IMF (Corker, Rehm, Kostial), Kosova: Çështje Makroekonomike dhe Stabiliteti Fiskal

3 EBRD Kosovë: Të ndërtojmë Paqen nëpërmjet Rritjes së Qëndrueshme, 3 nëntor 1999

4 World Bank, Analiza e Varfërisë në Kosovë, tetor 2001

5 IMF (Corker, Rehm, Kostial), Kosova: Çështje Makroekonomike dhe Stabiliteti Fiskal

6 Kategoria “ pronë shoqërore” ka qenë unike në Jusllavinë komuniste. Ndërmarrjet që ishin pronë shoqërore, vetëm teorikisht ishin pronë e punëtorëve, ndërsa praktikisht ato kontrolloheshin nga menaxherët komunistë.

7 ‘Joe Trutschler Go Home’, Koha Ditore, 17 gusht 2001

8 Shih raportin e ICG Nr. 120, Kosova: Zgjedhje Historike, 21 Nëntor 2001.

9 Regullorja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohëshme në Kosovë, Neni 5.1.

10 Korniza Kushtetuese, Neni 8.1.

11 Marëveshja e Përkohëshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë, 23 Shkurt 1999.

12 Shiko Raportin e Ballkanit të ICG No.79, Duke pritur UNMIK-un, 18 tetor 1999, për themelimin e UNMIK-ut.

13 Intervistë e ICG, mars 2001

14 Këtu klasifikohen ato biznese që kanë më pak se 10 punëtorë-dhe ju paguajnë 100 DM, krahasuar me bizneset më të mëdha që ju paguajnë 300 DM.

15 Regullorja e UNMIK-ut 2000/8, “Mbi Regjistrimin e Përkohshëm të Biznesit në Kosovë”, 29 Shkurt 2000.

16 Të dhëna nga Instituti i Statistikës i Kosovës, Shtator 2001.

17 Revista Ekskluzive, Dhjetor 2000

18 BRJ do të thotë Bundes -Republik-Jugoslavia

19 Koha Ditore, 3 shkurt 2001

20 Intervistë e ICG me zyrtarët e UNMIK-ut, tetor 20001

21 Regullorja e UNMIK-ut 29/2000, “ Mbi vendosjen e Tatimit të Paragjykuar”. Bizneset e vogla (përveç disa institucionve financiare) që kanë realizuar më pak se 15,000 DM të hyra bruto për 4-mujor, gjatë të gjithë 4-mujorëve kalendarikë të shkuar do të paguajnë 400 DM për 4-mujor. Bizneset e mëdha paguajnë normë fikse të tatimit të paragjykuar për 4-mujor, shtuar dhe pagesën prej tre për qind të të hyrave bruto për 4-mujor kur ato tejkalojnë shumën 15,000 DM. Për bankat dhe institucionet e tjera financiare, të hyra bruto konsiderohen të hyrat nga interesat, provizionet dhe komisionet. Për të gjithë tatimpaguesit e tjerë të mëdhën, të hyrat bruto nënkuptojnë shitjet bruto.

22 Intervistë e ICG me zyrtarët e AQF, nëntor 2001.

23 ‘Vendim i çuditshëm - legalizimi i turpit’, Koha Ditore, 26 janar 2001.

24 Intervistë e ICG , tetor 2001.

25 Intervistë e ICG me Riinvest, shkurt 2001.

26 Banka Botërore (BB), “Reformat Ekonomike dhe Sociale të Kosovës për Paqe dhe Pajtim”, Shkurt 2001.

27 Raporti tregon kontributet e diasporës në mënyrë të gjatë dhe tregimtare, kështu që për të patur një ide të përgjithëshme nevojitet një ripunim mjaft i detajuar i tij.

28 ICG ishte informuar që çmimi aktual i aplikimit për tu punësuar tek Shërbimi Policor i Kosovës ishte 1,500 DM, ndërsa çmimi për një dokument udhëtimi të UN ishte 1,000 DM.

29 Intervistë e ICG, mars 2001.

30 Një nga bizneset që dukshëm është rritur më shpejt janë pikat e karburantit, të cilat kanë lulëzuar në çdo rrugë kryesore. Mjaft bashkëpunëtorë i kanë sugjeruar ICG që një arsye strategjike për këtë rritje mund të jetë krijimi i një një rezerve të shpërndarë në të gjithë krahinën në rast të rishfaqjes së konfliktit. Një arsye e ngjashme u propozua për të shpjeguar dhe numrin e farmacive të reja.

31 Banka Botërore, “Reformat Ekonomike dhe Sociale të Kosovës për Paqe dhe Pajtim”, Shkurt 2001.

32 ‘ Në Kosovë , mbi 90 për qind e cigareve futet ilegaisht’, Zëri, 22 mars 2001.

33 Tarifa mbi importet aplikohet mbi çdo akcizë, kështu që rritet me 1.5%.

34 Banka Botërore (BB), “Reformat Ekonomike dhe Sociale të Kosovës për Paqe dhe Pajtim”, Shkurt 2001.

35 Publikimet UNMIK-ut: Rindërtimi i Kosovës 2000; Kosova 2001-2003 nga Rindërtimi tek Rritja. Agjensitë financuese janë kryesisht nga Suedia, Luksemburgu dhe Banka Botërore si dhe organizata jo-qevitare si Vizion Botëror (World Vision).

36 Intervistë e ICG me zyrtarë të Njësisë së Zhvillimit të Agrobiznesit’, mars 2001.

37 Bajrush Shala, profesor në Fakultetin e Bujqësisë, Universiteti i Prishtinës, *KosovaLive*, 18 tetor 2001.

38 Intervistë me një zyrtar ndërkombëtar nga Shtylla IV.

39 Intervistë e ICG me Punonjës të Doganës së UNMIK-ut, shtator 2001

40 Për shembull, një zyrtar i KB i ka treguar ICG që ai është quajtur fashist nga një kolegj i tij ndërkombëtar, kur ka shfaqur pikëpamjet e tij positive ndaj privatizimit.

41 Intervistë e ICG me kontraktorin USAID, gusht 2001.

42 Në kulmin e fazës së emergjencës gjatë fundit të 1999, tek Qendra Informative e Komunitetit Humanitar në Prishtinë e UNHCR/OCHA ishin të regjistruara më tepër se 400 NGO. Ky numër u përgjysmua në fillim të 2001.

43 Intervistë e ICG me Departamentin për Rindërtim.

44 Website i Agjensisë Europiane për Rindërtim.

45 Bashkimi European, *Kosova 2001-2003 nga Rindërtimi tek Rritja*, dhjetor 2000, f.34

46 Ibid.

47 Ibid, f.35.

48 Ibid, f.26.

49 Reuters, ‘ Shpërthejnë grindjet mbi Kontratën e Rrjetit Mobil në Kosovë’, 16 nëntor 1999

50 Zvogëlimi i gjerësisë së taracës nga afërsisht 100 metra në 30 metra, do të thotë që ekskavatorët të nxjerrin shtatë herë më shumë materiale të panevojshme (dhe dhe gurrë mbi shtresën e qymyrit). Një projekt për gërmimin horizontal do të zvogëlojë sasinë e materiale të panevojshme në raportin 1 me 1, në vitin 2002.

51 Menaxherët shqiptarë popozuan madje dhe alternativën e gërmimit të sa më tepër qymyri që të ishte e mundur pavarësisht nga dëmtimi i mundshëm i minierave. Intervistat e ICG , shkurt 2001.

52 Përveç ofertës së paplotësuar të NATO-s, së fundi ka pasur dy propozime. Njëri i është bërë qeverisë shqiptare nga bilioneri Bexhet Pacolli, dhe tjetri ka ardhur nga ish Kryeministri i qeverisë së vetëshpallur të Republikës së Kosovës, Bujar Bukoshi. Kostot parashikohet të jenë rreth 300 milion \$US.

53 Regullorja e UNMIK-ut 2000/8, “Mbi Regjistrimin e Përkohshëm të Biznesit në Kosovë”, 29 Shkurt 2000.

54 Regulloret e UNMIK-ut 200/68, ‘Mbi Kontratat për Shitjen e Mallrave’, 29 dhjetor 2000; 2001/3, ‘Mbi Investimet e Huaja në Kosovë’, 2001/5, ‘Mbi Pengjet’, 7 shkurt 2001; 2001/6 ‘Mbi Organizatat e Biznesit’, 8 shkurt 2001; 2001/11, ‘Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Kosovë’, 31 maj 2001; 2001/3, ‘Mbi Programin Pilot për vendosjen e Tatimit mbi Pasurinë e Tundshme në Kosovë’, 29 shtator 2001; 2001/ 25, ‘Mbi Licensimin, Mbikqyrjen dhe Regullimin e Kompanive të Sigurimit dhe të Ndërmjetësve të Sigurimit’, 5 tetor 2001; 2001_22, ‘Mbi Masat kundër Krimit të Organizuar’, 20 shtator 2001; dhe 2001/26, ‘Mbi Transaksionet e Pagesave’, 8 tetor 2001.

55 Banka Botërore, “Reformat Ekonomike dhe Sociale të Kosovës për Paqe dhe Pajtim”, Shkurt 2001.

56 Regullorja e UNMIK-ut 29/2000, “ Mbi vendosjen e Tatimit të Paragjykuar”, 20 maj 2000.

57 Regullorja e UNMIK-ut 2000/5, ‘Mbi vendosjen e Tatimit mbi Shërbimet Hoteliere, Ushqimin dhe Pijet’, 1 shkurt 2000. Ky tatim është hartuar kyesisht për të tatuar të huajt, të cilët janë përdoruesit kryesorë të hoteleve dhe restoranteve.

58 Regullorja e UNMIK-ut 2000/3, ‘Mbi Tatimin mbi Shitjet në Kosovë’, 22 janar 2000.

59 Regullorja e UNMIK-ut 2000/2, ‘Mbi akcizën në Kosovë’, 22 janar 2000.

60 Intervistë e ICG me zyrtarë të Autoritetit Qëndror Fiskal, nëntor 2001.

61 Regullorja e UNMIK-ut 20/1999, ‘Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave në Kosovë’, 15 nëntor 1999.

62 Intervistë e ICG, tetor 2001.

63 Intervistë e ICG, shkurt dhe nëntor 2001.

64 Banka Botërore, “Reformat Ekonomike dhe Sociale të Kosovës për Paqe dhe Pajtim”, Shkurt 2001, f.71.

65 Regullorja e UNMIK-ut 1999/13, ‘Mbi Licensimin e Institucioneve Mikro-Financiare Jo-Bankare në Kosovë’, 16 tetor 1999.

66 Riinvest, ‘ Ndërmarrjet Shoqërore dhe Transformimi/Privatizimi i tyre’, mars 2001.

67 Intervistë e ICG me një të punësuar në një ndërmarrje shoqërore, gusht 2001.

68 Sukseset e tjera përfshijnë: fituimi i një kontratë për të drejtuar fabrikën e përpunimit të produkteve bujqësore Progres në Prizren, nga kompania vendase Elif 19 dhe Abi në mars 2001; fabrika e betonit Betonjerka në qershor 2001; pularia dhe rezervati i peshkut, si dhe fabrika e pjatave plastike dhe e mallrave të derdhura, në korrik 2001; një prodhues i vajit të lulediellit në gusht 2001; një ndërmarrje e prodhimit të tekstileve dhe e punimeve të dorës në tetor 2001; dhe një fabrikë e prodhimit të tullave dhe blloqeve në nëntor 2001.

69 Intervistë e ICG me zyrtarë të DTI, shtator 2001.

70 Instituti Kosovar i Statistikës

71 Bashkëdrejtuesit ndërkombëtar të Departamentit të Arsimit dhe Shkencës i është kërkuar të komentojë këto pikëpamje mbi procesin e arsimit të shprehura nga individë të tjerë, por ai nuk është përgjigjur.

72 Artikull i botuar tek *Koha Ditore* nga Michael McClellan punonjës i Zyrës Amerikane në Prishinë, 7 nëntor 2001.

73 Përqindja e lindshmërisë në zonat urbane përputhej me atë të pjesës tjetër të ish Jugosllavisë.